Dukagjini "Nderi i Kombit"

Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 266, Dhjetor 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Realizimet e vitit 2025, bazë e rëndësishme për ecjen në realizimin e misionit të SHAD dhe programi për vitin 2026

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni! Në emër të Kryesisë së SHAD, ju informojmë mbi realizimin e programit për vitin 2025 dhe mbi programin e shoqatës për vitin 2026. Detyra kryesore e Kryesisë ka qene vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini". Në XXIII vjetorin e botimin të saj mbërriti në nxjerrjen e 266 numrave, që do të thotë, në 266 muaj nuk është ndalur asnjëherë në saj të punës së palodhur e mjaft të përgjegjshme të Redaksisë së gazetës dhe bashkëpunëtoreve të saj. Gjithsejte 3 926 artikuj, nga 682 autore të ndryshëm, me nga një artikull deri me 288 artikuj, Prele Milani; 273 artikuj, Ndue Sanaj; 197 artikuj, Luigj Shyti; 186 artikuj, Lazer Kodra dhe 117 artikuj, Zef Nika, 109 artikuj Roza Pjetri, [illegible] tjerë, sipas këtyre rubrikave: kulturë tradicionale dhe bashkëkohore 876 artikuj, portrete 950 artikuj, ...

3

Lahuta Shqiptare në UNESCO

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, me këtë rast thekson: "*Nga sot, trashëgimia kulturore jo materiale e UNESCO-s është edhe më e pasur. Arti i të luajturit, të kënduarit dhe punimit të lahutës, një nga thesaret më të çmuara të identitetit kulturor shqiptar, është bërë pjesë e saj*".

Sa lajm i gëzuar sa lajm i vonuar!

Sot gjithë Shqiptaret kanë të drejt të festojnë këtë ditë të shënuar për gjithë kombin tonë të lasht.

Me ne fund lahuta Shqiptare si pasuri botërore zuri vendin e merituar në UNESCO

Sa të gëzuar janë sot ata lahutar që janë sot në moshe, por dhe ata që janë të rinj e brezat që do të vijnë...

Sa të lumtur do ishin ata shumë lahutar, të cilët sot nuk jetojnë, po ta përjetonin këtë dite të gazuar

Të përulemi para tyre, për kontributin e dhanë në dekada e në shekuj, nëpër dasma e veprimtari të ndryshme kulturore deri në festivalin e Kombëtar të Gjirokastrës, me kontributin e tyre për ndërtimin e instrumentit, lahutën, në forma nga më të ndryshme deri me kokën e Gjergj Kastriotit, për tu paraqitur sa më tërheqës, me zërin e tyre, që sot e kemi të gjalle lahutën tonë!

Lahuta jonë Shqiptare monument i lashtësisë, identiteti jonë kombëtar, historia jonë e lavdishme, himni jonë shpirtëror kombëtar, gramatika e gjuhës tonë hyjnore; historia jonë e lavdishme; kushtrimi i luftës e i lirisë; orkestrina e këngës së shpirtit; forca e heronjve për qëndresë; simfonia e dasmave tona; vaji dhe ringjallja e trimave; legjenda e gjallë e lashtësisë sonë; historia jonë e lavdishme.

Nuk ka sesi të mos ndjehemi krenar për identitetin tonë kombëtar mijëravjeçar Ilir - Arbënor – Shqiptar. Vetëm ata që nuk kanë gjak Iliro - shqiptar nuk gëzojnë sot! Ata quajnë festen e shenjtë të Flamurit tonë Kombëtar ditë zije dhe nuk gëzohen për arritjet tona kombëtare; ndërsa shteti jonë mban qëndrim indiferent ndaj këtyre gjakprishurve; madje ka raste, që ata deklarohen publikisht dhe publikohen nëpër televizione kombëtare!?

Gëzohu shqiptar se asht dita jonë!

Në këto ditë gëzimi nuk duhet të harrohen ata dhjetëra, qindra e mijëra lahutar, të cilët e prunë lahutën deri në ditët tona, me vuajtje dhe sakrifica pafund. Në këtë ditë duhet kujtuar kolosët e lahutës, që nuk jetojnë ma: I madhi Gjergj Pllumi i Thethit, Mirash Ndue Mala i Shoshit; Lek Ndue Plaku i Planit, Zef Avdija i Curraj Eper, Syk Paplekaj i Lekbibaj, Gjelosh Vata i Breg lumit e të tjerë e të tjerë. Gjithashtu Kole Gjoni nga Shoshi, Sander Gurra nga Suma, Emanuel Suka nga Thethi, Lumturie Nonaj nga Shkreli, Luigj Gjerkaj nga Vermoshi, Ikona e lahutës Jonuz Delaj nga Nikçi, Mjeshtri i madh Pretash Nilaj e të tjerë.

Gjithashtu, sot përshëndes kolosët lahutar, të jetojnë: lahutarin e nderuar, Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" Nazmi Hajdari, dhe Nazmi Mehmetaj, Rifat Berisha, e të tjerë në Pejë, Klinë, Istog, iGjakove, i madh madhi Çun Lajçi, i riu i talentuar Kik Shllaku e Pashk Gjergjaj, kolosët e ansamblit "Rugova" Hysen Kurti e Uk Krasniqi, e të tjerë.

Dikur lahuta qëndronte e varur në mur krah me pushkën.

Armiqtë e kombit tonë nuk munden me vra kurrë lahutarin edhe pse deshën ta vrisnin të parin. Sot lahuta ka heshtur dhe qëndron krenare, por e vetmuar pasi interesi, për këtë instrument ka rene si rezultat i teknologjisë dhe globalizimit të shoqërisë njerëzore dhe mbështetja nga shteti është e pakt.

Për gjendjen e saj e thamë këto vargje:

Ne nji kull prej guri nji lahut e vjeter
Var ne nji ball murit e vetme ka mbetur
Teli ju ka kput zani ju ka shterr

Per me i ardh i zoti pret dimen e ver
Pret gjyshin e dashur me i knue si dikur
Ato kang te vjetra qe s' harrohen kurr
ndaj sot kjo asht gjendja e lahutes dhe lahutarve

Duke qenë se tani lahuta zuri vendin e saj në UNESCO, dëshirojmë dhe mendojmë, se edhe shoqëria dhe shteti do të kenë tjetër qasje ndaj lahutës e lahutarëve dhe ndaj kulturës. Lahuta e Xhubleta tani janë pasuri botërore, por ne duhet që të punojmë të gjithë dhe ta çojmë në UNESCO edhe Plisin e Bardhe; dhe këngën e gjate, apo maja krahut; gjëmën e burrave e shumë rite të tjera kombëtare, se edhe këto janë jo vetëm pasur Kombëtare, por nder të vetmet në nivel Botëror.

Një urim kam për ju të gjithë ju miq e koleg, që keni kontribuar dhe jeni bere faktor, që mundësuat dërgimin e lahutës Shqiptare në UNESCO kam një urim kushtim të veçantë poetik:

Moj Lahuta ilirjane

Sot festojmë për lavdin tane
Nder te madh kombit i bane
Tuj knue shqip ritet pagane
Prej n' Pellazg e deri sot
I ke knue e kjajt me lot

Per atdhe e bes te Zotit
Ke knue kang ti mot mas motit
Pirros, Gentit, Teutes e Agronit
Gjergj Elezit, Lekes e Kastriotit
Def Gjon Lulit e Boletinit
Mehmet Shpendit t' Dukagjinit

Teli jot me fije gjogut
E ka marr vallen e logut
Ja ka pri kangen Dasmorit
Ja ka nis dasmen malsorit
E i ka knue kanget e dashnis
Prush e flak zemrat rinis
Kur t' kan nije trimat tuj knue
Kan rrok armet me luftue
U ke dhan forc per me qendrue
U ke dhan zemer me fitue
Kno lahut ta kputsha harkun
Burrno djalin e rino plakun

Gjon Kosteri, 10 dhjetor 2025

KANGA E MALESIVE

Prej Malësisë së Madhe n' krye t' bjeshkëve t' larta
ku era sjell kangë t' trimave të motit
deri n' Dukagjin e n' kreshtat e Thethit
e shtrihet zani jonë n' krahina t' kombit

Prej Kukësit t' lartë e Hasit t' krenuar
Gjakovës me zemër, Pejës me lahutar
Istogut që flet me kroje të bardha
deri n' Mirditë e n' Peshkopi n' maja t' shkëmbit të tharë

E n' të gjitha këto vende, si motra të vjetra
qëndrojnë dy thesare t' fisnikërisë shqiptare
xhubleta që rrotullohet n' dritë të hanës
e lahuta që gjëmon historinë e malsorëve të parë

UNESCO-ja i priti me derë të hapun
"Ju jeni dritë e kombit, ju jeni amanet'
e malet u dridhën prej gëzimit t' zemrës
se na u njoft vlera, morali e nderi i vjetër në jetë

Ne malsorë krenohemi për këtë pasuni
se aty ka dinjitet, edukatë e burrni
aty rri shpirti i tokës i nanave t' bardha
i burrave që lanë fjalën si gur në ara

Sa t' këtë bjeshkë, sa t' këtë shqipe n' ajër
sa t' këtë flamur që valon mbi varg male
xhubleta e lahuta kanë me jetue përherë
si zemra t' bashkueme t' krejt Malesive shqiptare.

Vera Gjonaj

Realizimet e vitit 2025, bazë e rëndësishme për ecjen në realizimin e misionit të SHAD dhe programi për vitin 2026

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni! Në emër të Kryesisë së SHAD, ju informojmë mbi realizimin e programit për vitin 2025 dhe mbi programin e shoqatës për vitin 2026.

Detyra kryesore e Kryesisë ka qene vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini".

Në XXIII vjetorin e botimin të saj mbërriti në nxjerrjen e 266 numrave, që do të thotë, në 266 muaj nuk është ndalur asnjëherë në saj të punës së palodhur e mjaft të përgjegjshme të Redaksisë së gazetës dhe bashkëpunëtoreve të saj.

Gjithsejte 3 926 artikuj, nga 682 autore të ndryshëm, me nga një artikull deri me 288 artikuj, Prele Milani; 273 artikuj, Ndue Sanaj; 197 artikuj, Luigj Shyti; 186 artikuj, Lazer Kodra dhe 117 artikuj, Zef Nika, 109 artikuj Roza Pjetri dhe të tjerë, sipas këtyre rubrikave: kulturë tradicionale dhe bashkëkohore 876 artikuj,

portrete 950 artikuj, problematike 656 artikuj, krijimtari nga tradita e bashkëkohorja 516 artikuj, veprimtari të ndryshme 428 artikuj, përshkrime historie dhe natyrore 387 artikuj dhe për zhvillimin e shkollimit 113 artikuj.

Për vitin 2025 kane kontribuar financiarisht për botimin e gazetës vëllezërit Zef, Kristijan dhe Kalaudio Pali si dhe Valentina Luca, te cilët i falënderojmë përzemërsisht, me urimin popullor: Paçin e dhënçin!

Jane zhvilluar këto veprimtari:

Me 11 prill 2025, në mjediset e bar-restorant-hotel "TRADITA" u zhvillua takimi me kandidatet për deputet dukagjinas, përfaqësues të gjitha partive, nen drejtimin e N/kryetarit tç SHAD, Agron Hasani e N/kryetares Roza Pjetri, nen mbështetjen e z. Gjon Dukgiles.

Ne kuadrin e 100 vjetori i lindjes së Martin Camaj, 21 korrik 2025, pranë monumentit të tij, u vendosen kurora me lule nga Kryesia e SHAD, nga familjarët e tij, me në krye mbesën e tij, Vera Camaj, nen mbështetjen e z. Kole Çardaku... Morëm pjese në veprimtarinë që u zhvillua në bibliotekën "Marin Barleti", nen drejtimin e drejtoreshës Ledia Dushi.

Me datën 31 gusht 2025, morëm pjese në veprimtarinë "Plisi i Bardhë", me pjesëmarrjen e Kole Çardakut, Prele Milanit, te dy N/kryetare të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të cilët firmosen në emër të Shoqatës për të përcjellë propozimin për në UNESCO, me mbështetjen e Kole Çardakut.

Me datën 19 tetor veprimtaria "Homazh për veprën, jetën dhe kontributin e vyer të Luigj Shytit", ne bibliotekën "Luigj Gurakuqi", me mbështetjen e familjes Shyti.

Me datën 7 dhjetor 2025 promovimi i librit "Njomza" me autor Prele Milanin, në bashkëpunim me bibliotekën "Marin Barleti", me mbështetjen financiare z. Mhill Shkamit.....

Me datën 13 dhjetor 2025, promovimi i librit "Misionari në Shqipëri në fushën e betejës, me autor P. Libardi Cav. Camilllo O. M., përkthyer nga dr. Mark Palnikaj, në bashkëpunim me Bibliotekën "Marin Barleti", me mbështetjen financiare z. Viktor Arrinaj e Agron Hasanaj.

Kjo punë e këtij viti është një bazë nisje për punë më të plote për vitin 2026, për punë më të mirë në realizimin e MISIONIT të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Mbështetur në arritjet e këtij viti, në vitin 2025 do të punohet me ketë program:

1. Vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini", me 16 faqe, e vijueshme, Redaksia.
2. Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Rajonit, dhe propozimi i masave konkrete strukturave përkatëse, për ndryshimin e gjendjes, qershor-korrik 2025, Seksioni i shkollës.
3. Simpozium shkencore, me teme "Mundësit e zhvillimit të zonës së Dukagjinit", në muajin prill 2026, seksioni i turizmit, në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës.
4. Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge dhe zgjerimi i veprimtarive në hapësirat shqiptare, por dhe ne që duhet të ftojmë, për të bashkëpunuar, sipas rastit, seksioni i veprimtarive.
5. Veprimtari festive kushtuar 7-8 Marsit, në veçanti për nderimin e nxënësve të shkëlqyer në mësime të klasës së 9-të, të vitit të katërt të shkollës së mesme dhe studente dukagjinas të vitit fundit, seksioni i shkollës, i gruas dhe veprimtarive të SHAD.
6. Promovime të botimeve të reja, sipas rastit ...Seksioni i librit;
7. Përfundimi e rivendosja e monumentit të ri albanologut Martin Camaj dhe riinaugurimi i tij, me rastin e 101 vjetorit të lindjes së tij, korrik 2025, Kryesia.
8. Konferenca IX e SHAD, maj 2026.

***

Në emër të SHAD, ju uroj Gëzuar festen e lindjes së Jezuesit dhe vitin e Ri2025, një vit të mbare në jetën tuaj, në jetën familjare, në punë dhe kudo për të bere jetën më të mirë, më të begatë!

Ndue Sanaj, Kryetari i SHAD

Portreti i Prele Milanit, për femrën Shqiptare

"Njomza" nën kujdesin e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Në Bibliotekën "Marin Barleti", me datën 7 dhjetor 2025, në prezencën e një auditori të botës intelektuale, u prezantua novela Njomza" e shkrimtarit, studiuesit e publicistit Prele Milani, gjithçka nën kujdesin e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në bashkëpunim me drejtorinë e kësaj biblioteke.

Nën drejtuesen zj. Dukate Bregu, Kryetarja e Këshillit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", sot ishte dita të flisnin zonjat dhe zonjushat për njomëzën, ashtu siç e kishte përcaktuar edhe vetë autori z. Prele Milani, gjithçka një himne i dashurisë njerëzore dhe dashurisë për gruan.

Në këtë simpozium promovimi të këtij libri, folën vajzat me shumë shkëlqim e me ekselencë, duke e trajtuar e ndezur librin me shpirtin e autorit, e kjo patjetër të kënaq se, do pasojmë breza.

Ndërsa Prelë Milani, e përshkroi librin me thjeshtësinë e një burri kur bën veprën, me fjalë zemre e falënderim për pjesëmarrësit.

Po veçoj mesazhin e zj. Shpresa Ftoni, e cila kulmoi në perceptimin e ngjarës së Njomëzës, ajo e përkëdheli mjeshtërisht fjalën e fjalinë, duke e ngritur njomëzën shqiptare në lartësinë e qiellit të merituar.

Gjithashtu mesazhe sollën poetja Mimoza Rexhvelaj, mësuese Merita Curri, zj. Ruduna Bardhi, poetja Bona Mulaj, zj. Majlinda Laçaj dhe me leximin e poezive Anila Milani.

Në këtë kumtesë letrare burrat vetëm sa dëgjuan, por u përzgjodhën disa të përshëndetin, aty përshëndeti Dr. Mark Palnikaj, Prof. Zef Gjeta, publicisti Kadri Fikaj e Mjeshtri i Madh, Ilmi Kurti.

***

Po e mbylli ketë komikë, me poetin Lazer Kodra, duke përcjell një pjesë nga parathënia, i cili i mungoi kësaj veprimtarie mjaft e arrire në pjesëmarrje e nivel kulturore sot, duke i uruar shërim të shpejtë, që "Njomza" erdhi e veshur me të gjitha virtytet më të mira të gruas shqiptare

"Novela "Njomëza", është një proze realiste, racionale, e cila për shfaqe vërtetësinë dhe ndjeshmërinë e hollë të lirizmit, ironinë e fatit dhe madhështinë e epikes heroike të një mozaiku karakteresh larushan me gjeografi të gjerë.

Autori vjen para nesh krejt natyrshëm, i ngarkuar si bleta me pjalmit më proverbiale të së folmes burimore gegnore. Diku të përlotë me rrëfimet dramatike gendistare e diku, diku flet plot frymëzime krahëlehta për dashuritë shenjtore e mëkatare; diku, diku trishtimi i tij thinjet dhe rebelohet ndaj veseve më të ulëta njerëzore. Gjysmë i trishtuar dhe gjysmë krenar vozite mes motesh të largëta e të afërta, duke shpalose me thjeshtësi idetë e personazheve që ndeshen e përplasën njeri me tjetrin deri në antagonizëm pa fre.

"Njomëza" shtjellon disa ndodhi jetësore të viteve 20-30 të shekullit 20-t.

Subjekti i novelës, fillon me një romance të kristalte dashurie, që thyen shtambën e tabusë tradicionale, duke përfunduar në një hakmarrje spartane!....".

***

Falënderojmë mundësorët, që bënë të mundur realizmin e kësaj veprimtarie: z. Mhill Shkami e Viktor Arrinaj! I urojmë me shprehjen popullore: "Paçin e dhëncin"!

Përgatiti, Agron PREBIBAJ



Promovimi i librit "Misionari në Shqipëri në fushën e betejës" mbledh dashamiret e kulturës në bibliotekën "Marin Barleti"

Një veprimtari e veçantë kulturor u zhvillua më 13 Dhjetor 2025 – në ambientet e Bibliotekës "Marin Barleti", Shkodër, ku Shoqata Atdhetare "Dukagjini" organizoi promovimin e librit "Misionari në Shqipëri, në fushën e betejës", botimi në gjuhën shqipe i veprës origjinale "Il missionario albanese sul campo di battaglia" nga P. Camillo Libardi.

Libri i dedikohet figurës së shquar të misionarit françeskan P. Alberto Cracchi, ipeshkëv i Pultit, dhe paraqet një dëshmi të përkushtimit, sakrificës dhe humanizmit ndaj popullit shqiptar në kohë sfidash të mëdha.

Një hapje e ngrohtë dhe e përkushtuar: Promovimin e hapi Znj. Suela Ndoja, anëtare e Kryesisë së Shoqatës, e cila mirëpriti të ftuarit, studiuesit dhe dashamirësit e kulturës. Ajo theksoi rëndësinë e këtij promovimi për njohjen e figurave historike dhe pasurimin e literaturës shqiptare me vlera morale dhe humanitare. "Ky libër është më shumë se një botim historik; është një dëshmi e gjallë e misionit dhe dashurisë për popullin shqiptar, një model shprese dhe humanizmi," tha ajo.

Promovimi vijoi me prezantimin e **Dr. Mark Palnikaj**, përkthyesi i veprës dhe studiuesi i njohur i dokumenteve historike të gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Dr. Palnikaj ka kryer kërkime të thella në arkivat ndërkombëtare, përfshirë Vatikanin, Venecian, Napolin, Loretos dhe deri në Armeni, ku ka zbuluar dokumente të rëndësishme shqipe dhe latine. Ai është vlerësuar me titullin **"Qytetar Nderi i Qytetit të Fermos"**, për publikimin e një dokumenti historik të vitit 1652; eshte vlerësuar me titullin "Anëtar Nderi i SHAD" dhe me "Mirënjohjen Marin Camaj".

Roli i tij si përkthyes garantoi që lexuesi shqiptar të kishte një tekst të saktë, të frytshëm dhe të ruante të gjitha nuancat historike, morale dhe sociale të veprës origjinale.

Dr. Mark Palnikaj prezanton veprën: Një moment i veçantë ishte prezantimi i Dr. Mark Palnikaj, përkthyesi i librit dhe studiues i njohur i historisë shqiptare. Ai ndau motivin e përzgjedhjes së veprës për përkthim: "Më tërhoqi figura e P. Alberto Cracchi për humanizmin dhe përkushtimin e tij ndaj popullit shqiptar. Lexuesit shqiptarë duhet ta njohin këtë figurë, që na mëson se sakrifica dhe shërbimi ndaj bashkësisë janë vlera të çmuara. "Gjatë bashkëbisedimit të hapur, Dr. Palnikaj foli për episodet që e preknin më shumë nga libri, sfidat dhe bukuritë e procesit të përkthimit dhe ndikimin që ky libër mund të ketë tek të rinjtë dhe brezat e ardhshëm".



Reflektimet e të ftuarve: Pas bashkëbisedimit, u hap një rreth i fjalëve dhe reflektimeve të të ftuarve të nderuar:

Leonard Qyteza, studiues dhe publicist, vlerësoi thellësinë historike dhe kulturore të veprës dhe ndikimin e P. Alberto Cracchi në bashkësi: "Kjo vepër na ndihmon të kuptojmë jo vetëm historinë, por edhe dimensionin human dhe moral të figurave që kanë sakrifikuar e që kane lënë gjurmë në kulturën tonë."

Prelë Milani, studiues, publicist, poet dhe N/kryetar i SHAD, analizoi dimensionet morale dhe humanitare. Nder te tjera ai theksoi: "Libri tregon se humanizmi dhe sakrifica janë mesazhe me vlera madhore që duhet të përcillen brezave të rinj."

Roza Pjetri, N/kryetare e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", theksoi rëndësinë e përkushtimit dhe punës kolektive: "Autorë si Palnikaj, që na kanë sjellë vepra të tilla na kujtojnë se përkushtimi dhe solidariteti janë baza e shoqërisë tonë e se duhet të bashkohemi për këto."

Luigj Mila, Sekretar i Këshillit të Paqes, lidhi mesazhet e drejtësisë dhe etikës të librit me rëndësinë sociale: "P. Alberto Cracchi na mëson se drejtësia dhe etika nuk janë thjesht fjalë, por veprime konkrete në shërbim të bashkësisë"

Suela Ndoja, psikologe, ofroi një analizë socio - psikologjike: "Veprimet e misionarit tregojnë dimensionet morale, sociale, psikologjike dhe humanitare, që ndikojnë thellësisht tek shoqëria dhe identiteti ynë kulturor."

Ndue Sanaj, kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", përgëzoi autorin Dr. Palnikaj dhe ne emër te Kryesisë së SHAD, dozoj titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", për P. Libardi Cav. Camillo O.M., pas vdekjes, me motivacion: **"Për veprimtarinë e tij 45-vjeçare në funksionin e misionarit i shërimit të shpirtrave njerëzor në Dioqezën e Pultit, në kohën më delikate të shtetformimit. Ai vijoi t'i shërbente çështjes kombëtare me përkushtim të palëkundur, si studiues i historisë shqiptare, ku përmes shkrimeve, dëshmive okulare dhe hulumtimeve ndihmoj në ruajtjen e kulturës e dokumentimin e traditave, ndriçimin e ngjarjeve patriotike e kombëtare të viteve 1910–1912 dhe ngjarjet politike të viteve 1920 -1926 , Libardi i la trashëgim historisë së Shqipërisë një arkiv, me fakte nga më të çmuarat e çerek shekullit të pare të shekullit XX"**

Nderoj me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me vendim nr. 295, date 20 nëntor 2025:

1-Gazetari Gëzim Vuçaj,
2-Gazetari Fran Gjoka,
3-Studiuesi, poeti e publicisti Gjon Marku,
4-Vëllezërit Zef, Krisitjan e Kloudio Pali,
5-Valentina Luca,
6-Avokatin Sokol Dedndreaj,
7-Gazetari Vasel Gilaj
8-Gazetari Musa Kurtulaj
9- gazetari Marjo Gjini
10- Intelektualin L eonard Qyteza

Fjalët përmbyllëse dhe mbyllja e aktivitetit: Promovimin e mbylli përsëri Dr. Mark Palnikaj, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët, duke theksuar rëndësinë e përkushtimit dhe bashkëpunimit për ruajtjen e identitetit kulturor dhe historik të Shqipërisë.

Veprimtaria përfundoi me fotografi dhe biseda të lira e kafe sociale mes pjesëmarrësve, duke lënë një përshtypje të thellë dhe duke forcuar lidhjen mes historisë, kulturës dhe bashkësisë.

Me këtë, promovimi i librit "Misionari në Shqiperi në fushën e betejës" u realizua me sukses, duke ofruar një eksperiencë të pasur kulturore dhe intelektuale për të gjithë pjesëmarrësit.

Përgatitur nga
Suela Ndoja

Infermierja, që dashuroj profesionin dhe e ktheu atë në art e pasion, Leze Bungaja

Lezja lindi në fshatin Plan, të krahinës së Pultit, me 28 dhjetor1964, e bija e Ndue e Luke Lera. Ajo, që në moshë të vogël kishte shfaqur dëshirën, kur të rritej do të behej një infermiere, ndonëse prindërit dëshironin që të vijonte shkollën për mësuese. Shkollën 8-vjecare e mbaroi në vendlindje, në vitin 1979, me rezultate shumë të mira dhe menjëherë pas saj, ajo vijoi shkollën mjekësore në Vlore, në vitet 1979-1983, ndonëse larg dhe me vështirësitë që kishte familja, ajo mbaroi studimet për infermiere - mami me rezultate shumë të mira. Prindërit i kërkonin që të vijonte studimet për tu bere mjeke, por Lezja priste me padurim të fillonte punën në profesionin e ëndërruar dhe e dashuronte. Gjithashtu ajo, donte që t'u vinte në ndihme me rrogën e saj edhe prindërve, vëllezërve e motrave, në ndihme për shkollimin e tyre. Në muajin gusht të vitit 1983 fillon punën në detyrën e infermieres, në fshatin Plan, në cilin shërbeu për gjashte vite rresht, me një dëshire të madhe në shërbim të banorëve të fshatit. Gjate kësaj kohe fitoj besimin, admirimin dhe respektin, fale etikes, humanizmit, përkushtimit dhe aftësive të saj. Ajo rriti cilësinë e shërbimit shëndetësor, ndihmoi në uljen e vdekshmërisë foshnjore dhe në edukimin shëndetësor të banoreve. Krahas punës profesionale, ajo dha kontributin e saj edhe me organizatën e rinisë dhe në organizimin e zhvillimin e veprimtarive kulturore e artistike të krahinës! Në vitin 1989, Lezja martohet me Pjeter Bungaja nga fshati Nderlyse - Theth. Pjetri dha kontributin e tij prej 42 vitesh në policinë e shtetit dhe në fund të karrierës u nderua nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit: "Për merita të veçanta, përkushtim e profesionalizëm në përmbushjen cilësore të detyrave në policinë e shtetit". Në vitin 1990, Lezja transferohet në Shkodër dhe punësohet infermiere në spital, në repartin Ortopedi . Më pas vijon punën në repartin Urgjence, në vitet më me fluks pune dhe pasigurie, duke përfshire edhe vitin e trazuar 1997. Nga viti 2000 e në vijim punon në repartin e kirurgjisë, në SRSH. Në vitin 1991 dhe 1993 lindin dy fëmijët e tyre, Elton dhe Aldi Bungaja. Këta janë shkolluar në Universitetin "Luigj Gurakuqi", në Shkodër dhe më vonë kane emigruar në Amerike. Vitet 1990-2000 ishin vitet me më shumë sakrifica të çiftit Bungaja pasi kishin dy profesionet më të vështira, ndërkohe që duhet të kujdeseshin edhe për fëmijët, që shpesh siç thotë ajo, i mbyllnim natën vetëm në shtëpi dhe shkonim në punë. Megjithatë në spital vijoi të punonte çdo dite me shumë dashuri e përkushtim ndaj pacienteve, duke fituar respektin e të gjithë atyre me të cilët punonte, pacienteve dhe familjareve. Ajo ka dhëne kontribut kudo që është ndodhur, në veçanti me urgjencën e që mbante me vete dhe shumë njerëz e kujtojnë dhe vlerësojnë si shpëtimtare e tyre. Vijimisht dëshironte të shtonte njohuritë, për profesionin, duke marre pjese në kurse trajnimi, duke u pajis me çertifikata aftësie. Ajo vazhdoi gjithnjë të ndihmonte dhe të përkrahte edhe banoret e krahinës sa here që kishin nevoje, duke i ndihmuar edhe jashtë repartit dhe jashtë orarit të punës. Ajo kishte mbjelle besimin tek ata dhe ndiheshin të lumtur kur e takonin. Me etiken, humanizmin e saj u ktheu buzëqeshjen pacienteve të saj dhe i beri të ndiheshin mirë në ditët më të vështira për shëndetin e tyre. Në vitet 2006-2009 vijoi studimet e larta për Infermieri të Përgjithshme, në Universitetin "Luigj Gurakuqi", me rezultate shumë të mira. Fale aftësive profesionale dhe rezultateve në shkollë, që nga viti 2009 e në vijim, ajo është aktivizuar në Universitetin "Luigj Gurakuqi", në Shkodër, në detyrën e pedagoges së jashtme për praktikat profesionale në degën Infermieri, një pasion e një përkushtim tjetër i saj për të përgatitur infermiere të ardhshëm profesioniste, duke qenë shembulli më i mirë i etikes dhe humanizmit. Ajo është një infermiere dhe referues e admiruar nga studentet e infermierisë. Në vitin 2013-2015 mbaron studimet për Master Profesional Psikologji Shëndeti, po me rezultate shumë të mira.

Lezja punon prej më se 30 vitesh në repartin e kirurgjisë, në spitalin Rajonal Shkodër, një repart me fluks të madh pune, me shumë arritje e suksese, por edhe i vlerësuar nga Ministria e Shëndetësisë, nje nga kururgjitë më të suksesshme në vendin tonë.

Lezja tregon se, ndihet me fat, që ka qene pjese e këtij grupi të mrekullueshëm nder vite, që ka punuar me mjeke ekselente dhe shumë të përkushtuar të kohëve të mëparshme, të brezit të saj dhe mjek të rinj profesioniste, që kryejnë të gjitha ndërhyrjet kirurgjikale në Shkodër fale aftësive të tyre profesionale dhe teknologjive të reja. Spitali Rajonal i Shkodrës ka nxjerre emra të mëdhenj të mjekësisë shqiptare, të cilët me punën e tyre kanë shkruar historinë, ndërsa trashëgimia e atij brezi të artë mjekesh e infermieresh të përkushtuar vijon edhe sot. Për mua thotë ajo, - ishte fat dhe nder të punonte me ekipin e kirurgjisë Shkodër, me mjeke dhe infermiere profesioniste, human dhe të përkushtuar, të cilët shkruan historinë e artë të kirurgjisë në Shkodër, por edhe me infermiere të brezave më të vjetër, të cilët kanë punuar me humanizëm e përkushtim.

Ajo krahas punës infermiere gjate gjithë kohës ka bere edhe punën e psikologes me pacientet dhe familjaret. Lezja ka mbi katër dekada në këtë profesion dhe siç na thotë ajo: "Nuk më është zbehur kurrë dëshira dhe pasioni për profesionin e saj. Gjate gjithë këtyre viteve, në çantën time nuk kane munguar medikamentet e urgjencës kudo ku kam shkuar. E ndjeja për detyre tu gjendesha në çdo kohë dhe kudo e gatshme për të dhëne ndihmën time". Lezja është anëtare e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe nga viti 2023 është anëtare e Kryesisë së Saj, në detyrën e kryetares së seksionit për gruan.

ROZA PJETRI

Libri "Kalomira"

Libri "Kalomira" u bë i dashur për të gjithë! M'u dha rasti të bej një vizite te Panairi i librit, në Tiranë, më tërhoqi vëmendjen pavijoni "Nacional" ku ishin bashkuar shumë shkrimtare, që po flisnin për librin me tregime "Kalomira" të shkrimtarit të mirënjohur Kozma Gjini.

Me Kozman kemi shoqëri që 6 dekada, na ka bashkua fillimisht gazeta "Mësuesi.

Mu bë zemra mal, u gëzova shumë kur mësova se Kozmai kishte 17 "fëmijë", pra 17 libra të botuara.

Para se te shkruaj për "Kalomira" po ndalem te redaktori i librit.

Një redaktor i mirë nxjerr në jetë libra të mira. Por kush është ky redaktor? Redaktori është Muj Buçpapaj me origjine nga Tropoja, me grade shkencore profesor doktor, i cili drejton televizionin, radion, portalin dhe gazetën "Nacional", e cila si gazete javore mund të themi se ka zëvendësuar gazeten "Drita" dhe revistën "Nëntori" të asaj kohe.

Profesor doktor Muje Buçpapaj, është shkrimtari i cili ka fitua disa çmime ndërkombëtare, autore i 70 veprave letrare, i përkthyer në të gjitha kontinentet e botes dhe pas Kadaresë është shkrimtari shqiptar i pari i përkthyer në bote.

Po korrektori Sazan Goliku (Pandeli Koci), i cili solli letërsinë e Kosovës në Shqipëri dhe ka qene shkrimtari me i botuar në Kosove. Sot ky është shkrimtari më i dashur i letërsisë fëmijërore.

Kjo ese e Kozma Gjini (Kalomira) ngelet në mendje ku neve çojmë leterkembimin e Hyske Berbojkes (Gaqoveshi) ishredaktor i revistës "Hosteni". Tregimet e Kozmait janë të gezueshme po aq edhe të dhimbshme. Uji, që rri qelbet, ndersa Kozmai lexon, shkruan dhe është i veçantë në fushën e letrave.

Ky shkrimtar i Myzeqesë po gjen lexues të dashur edhe në Malësinë e Gjakovës, Tropoje.

IBRAHIM HAJDARMATAJ



PAKETA E ALPEVE

Bashkia Tropojë është një njësi administrative në verilindje të Shqipërisë, pjesë e qarkut të Kukësit. Ajo përfshin një territor prej 1,057.3 km² dhe ka një popullsi prej rreth 14,189 banorësh, sipas Institutit të Statistikave.

Në qendër të fshatit Tropojë u organizua një takim pune me kryetarët e fshatrave të njësive administrative Tropojë, Bytyç dhe Margegaj. Administratori i njësisë administrative Tropojë, Adem Beli, kishte bërë një përgatitje serioze për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Inxhinieri i talentuar Kristaq Puleri bëri prezantimin e "Paketës së Alpeve". Po kështu, kryetari i Bashkisë Tropojë, Rexhë Byberi, u ndal tek rezultatet e pritshme që do të ketë Tropoja nga këto projekte.

Inxhinieri Egzon Muhameti, nëpërmjet skicave, demonstroi projektin para të pranishmëve. Me shumë interes u ndoq edhe fjala e administratorit të njësisë administrative të Bytyçit, Isa Hoxha.

Fjalë përshëndetëse mbajtën edhe administratori i njësisë administrative të Tropojës, Adem Beli, si dhe përgjegjësi i njësisë administrative të Margegajve, Flor Metaliaj.

Unaza e Bjeshkëve prej Markoshit në Tropojë, duke përfshirë rrugën e Dragobisë dhe të Ceremit, do të jetë një rrugë me standarde të larta. "Rruga e Alpeve Turistike" mundëson zhvillimin e Tropojës, duke kaluar shumë afër staneve ekzistuese, ndërsa në Qafën e Dobërdolit, në 2200 metra mbi nivelin e detit, do të ndërtohet edhe një tunel 1 km e 20 metra i gjatë.

Ky projekt do të ketë mbi 1 mijë kilometra katrore shtrirje gjeografike.

U theksua gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit me shtetin kufitar Mali i Zi, duke u lidhur me rrugë automobilistike, e cila do të sjellë zhvillim turistik, ekonomik dhe kulturor.

Pjesëmarrësit u zotuan se do të japin kontributin e tyre në drejtim të "Unazës së Bjeshkëve" dhe "Paketës së Alpeve".

IBRAHIM HAJDARMATAJ

Sot dita e ndarjes nga 'sëmundja' më e madhe, Otomanizmi

Nga Ben BLUSHI

Sot është dita jonë e Madhe e Pavarësisë që u arrit pas 500 vjet pushtimi barbar nga otomanët dhe platforma e tyre otomanizmi.

Otomanizmi është një një doktrinë fetare dhe racore për të asimiluar popujt e pushtuar.

Otomanizmi na hoqi dashurinë për punën, për artet, për gjuhën si dhe na krijoi një raport të shtrembër me kohën.

Otomanët na bindëm se vonesa nuk është diçka e keqe.

Një punë që nuk bëhet sot mund të bëhet nesër ose mund të mos bëhet fare.

Vonesa na u kthye në tipar kombëtar.

Fat i madh i pasojave drithëruese të otomanizmit në Shqipëri është mungesa e fotografisë në shekujt 16, 17, 18 dhe 19.

Nëse do kishte pasur fotografi për të treguar mjerimin e shqiptarëve të asaj kohe shqiptarët e sotshëm do lebetiteshin.

Atyre që mbrojnë këtë mizori do u vinte turp, megjithëse mungesa e dëshmive nuk mund të jetë justifikim për ata që mbrojnë shfarosjen e kombit të tyre.

Në atë kohë rrugët e Shqipërisë ishin të mbushura me njerëz të leckosur, të paushqyer dhe të sëmurë.

Një e treta e vendit jetonte në kënetë.

Nuk kishte asnjë shkollë, asnjë spital, asnjë port, tokat nuk bonifikoheshin dhe këtu nuk kalonte asnjë hekurudhë.

Shqipëria ishte një territor i izoluar nga ku merreshin vetëm bagëti dhe ushtarë dhe ku nuk cohej asgjë veç armëve për të shtypur ata që nuk bindeshin.

Mjetet që u përdorën nga otomanët ishin dhuna, uria, malarja, vrasjet dhe taksat.

Por të gjitha tiparet e otomanizmit e klasifikojnë atë si një nga format më të egra të kolonializmit.

Ata që nuk e dinë çfarë është otomanizmi duhet të dinë se kjo perandori barbare i taksonte njerëzit sipas përkatësisë fetare.

Kush nuk ishte musliman paguante taksë.

Kjo taksa mbi fenë quhej xhizve.

Shtetet vendosin taksa mbi pronën, mbi tokën, mbi punën, mbi fitimin dhe mbi tregtinë.

Perandoria Otomane vendosi dhe një taksë mbi shpirtin, prandaj ajo është më e pashpirt se të gjithë pushtuesit që na kanë rënë mbi shpinë.

Xhizve ishte një lloj xhezveje ku përvëlohej me ujë të ndenjur ndërgjegjja jonë kombëtare.

Kolonializimet janë gjithnjë të rënda, të dëmshme dhe shfarosëse megjithatë ka disa lloje kolonializmi.

Në kohën kur spanjollët, portugezët dhe më pas anglezët dhe francezët morën detet për të pushtuar botën ne që ishim shumë afër tyre patëm fatin më të zi.

Turqit osmanë, pra otomanët që nuk kishin flota për të shkuar në Amerikë dhe Azi për të zbuluar Kinën, apo Afrikën iu sulën Ballkanit.

Në vitin 1492 kur Kristofor Kolombi shkoi në Amerikë, otomanët e pushtuan plotësisht Shqipërinë pas pothuajse 50 vjet përpjekje dhe rrethim të egër.

Skënderbeu kishte vdekur në vitin 1468 dhe Shkodra ishte pushtuar në vitin 1479.

Pas këtyre dy humbjeve nisi një fazë pushtimi brutal dhe fatkeqësia jonë është se ndryshe nga ajo e shumë popujve të tjerë u kolonizuam nga një popull më i pacivilizuar se ne.

Në cdo kuptim të fjalës otomanët e viteve 1400 ishin shumë më të pazhvilluar se shqiptarët.

Ata ishin fise të vogla që bënë një shtet duke na pushtuar, ne ishim shtete të vogla që u kthyem në fis duke u pushtuar.

Është cinike ta them, por ne patëm më pak fat se indianët e Amerikës, apo shumë popuj afrikanë që u pushtuan nga popuj më të zhvilluar se ata.

Ne ramë në një lagështirë morale që na kalbi për 500 vjet.

Prandaj Otomanizmi nuk ishte një pushtim por ishte një kolonializim.

Kur otomanët ikën nuk lanë asgjë pas.

Shqipëria post otomane doli si vendi më i varfër, më i grabitur, më i paditur, më i sëmurë, më i vogël dhe më i uritur në Evropë.

Asnjë armik nuk na ka trajtuar më keq se otomanët gjakatarë.

Ata na zhveshën nga nevoja për të punuar, për të ëndërruar dhe për të jetuar me drejtësi.

Ata na ndanë nga trungu dhe na lanë të kalbemi në moçalin e tyre thithës.

Pa pushtimin otoman historia jonë do ishte më e ndritur dhe sot do ishim një popull evropian më i madh dhe plotësisht i integruar.

Prandaj përpjekja e Ismail Qemalit që duke kaluar mes baltërave të kohës arriti ta shpallë Shqipërinë të pavarur në 28 nëntor të vitit 1912 është ndoshta akti më kurajoz i historisë sonë.

Të gjitha të këqijat që kemi pësuar dhe po pësojmë ende dhe sot e kanë burimin atje.

Te ato 500 vjet errësirë, poshtërim dhe përulje kombëtare.

Otomanizmi është sëmundja jonë që duhet ta shërojmë deri në fund.

Jam i bindur se do t'ia dalim.

Dasma shkodrane në kujtimet e mija

Në librin tim të botuar më 2012 "Gruaja shqiptare në vështrimin e të tjerëve" kam bërë disa studime se si e kanë parë të tjerët (sidomos të huajt) gruan shqiptare për sa i përket gjendjes sociale, pjesëmarrjes në luftë, bukurisë së saj, e të tjera. Një nga këto tema mjaft interesante është edhe per martesat dhe dasmat shqiptare. TË HUAJT PËR MARTESAT DHE DASMAT SHQIPTARE Nuk i kanë ikur vëmendjes së shumë studiuesve martesat ndër shqiptarët, duke parë më shumë anën nënshtruese dhe fyese që gruaja shqiptare është e kondicionuar t'a pranojë pa pasur asnjë të drejtë në zgjedhjen e bashkëshortit. Martesa si një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut, me karakter të theksuar historik ka pësuar ndryshimet në proçesin e kalimit nga një formacion ekonomiko-shoqëror në një tjetër. Ajo ka ndryshuar sipas traditave të zonave të ndryshme, që i janë nënshtruar të drejtës zakonore, duke ruajtur edhe shumë nga zakonet e kaluara që modernizoheshin nga një sistem në një tjetër, deri në ditët e sotme. Ndryshime pësoi martesa dhe ceremonitë e dasmës sidomos pas vitit 1944 ku sistemi i ri kondicionoi edhe ndryshime në lidhjet martesore si dhe ceremonitë e dasmës që u thjeshtuan mjaft, për të marrë formën e tyre më të lirë mbas viteve 1990. Por gjithmonë për studiuesit dhe udhëtarët para viteve 1944, mbeti tradita dhe ceremonitë martesore të shqiptarëve, disa nga të cilat përmenden në referimet e mëposhtme. Uilliam Martin Lik, në veprat e tij në mes të tjerave është ndalur edhe tek pozita e gruas në familje dhe respekti burrë –grua. Në këtë kontekst ai ndalet tek qëndrimi i burrit ndaj gruas, posaçërisht kur burri e trajtonte me kujdes dhe e respektonte duke shmangur me rreptësi konfrontimin me botën femërore. Ai vë re se shqiptarët kishin martesa të ndryshme. Muhamedanët martohen me gra të krishtera. Të rinjtë e familjeve të përziera, konvencionalisht rriten si muhamedanë, ndërkaq vajzat si të krishtera dhe mishi i dashit me atë të derrit hahen në të njëjtën sofër. Tek artikulli "Tirana , kryeqyteti" në librin "Nëpër udhët e Shqipërisë" të Noelle Roger", shkruhet: "Habitesh tek sheh, në krahë të tyre gra trupvogla e të imëta. Të martuara shumë të reja përpara se të arrijnë zhvillimin e tyre të plotë, ato lindin shumë fëmijë dhe ndihmojnë burrin në të gjithë punët e shtëpisë. Sytë e tyre të bukur iu buzëqeshnin mbrapa perçeve. Sa shumë do të doja të njihja mendimet e tyre! Në artikullin "Shkodra e Shqipërisë" shkruan: ..Në sajë të udhëtares shqiptare patëm rastin që në Shkodër të merrnim pjesë në martesën e një fshatareje të fesë së krishterë. Na shoqëruan në një dhomë ku gjendeshin shumë njerëz. Nusja u ngrit në këmbë dhe qëndroi ashtu pranë murit me sytë e ulur. Ishte veshur me xhaketë të trashë e të përgatitur me një cohë të rëndë dhe shumë të gjatë e të gjerë, si dhe të zbukuruar tepër me perla dhe zekinë, të cilat i bënin të dukej mjaft e madhe në moshë. Mbi flokë kishte një pafundësi zbukurimesh dhe lulesh. Qëndronte e palëvizur, e heshtur e si e huaj ndaj gjithçka që ngjiste rreth saj, ndërkohë që kushërirat dhe mikeshat e saj bënin muhabet me gjysmë zëri tek pinin kafe dhe limonade. Sa herë që hynte dikush ajo ngrihej sipas të njëjtit ritual automatik, me sytë përdhe e pastaj ulej përsëri. Dukej si një priftëreshë e zbukuruar dhe e stolisur sikur do të merrte pjesë në ndonjë rit e veçanërisht të shenjtë. Dhe kjo zgjaste pesëmbëdhjetë ditë, gjatë të cilave ajo nuk duhej as të fliste e as të shihte njeri. Pastaj i shoqi vinte e merrte për në shtëpinë e tij. Ceremonia myslimane është pak a shumë e njëjtë. Me të vetmin ndryshim se në dhomën ku qëndronte nusja nuk lejohej te futej asnjë mashkull. Njëkohësisht nusja e kishte fytyrën të pudrosur dhe kapakët e syve të lyera. Tek artikulli "Kufiri i jugut" ajo shkruan:..."Tradhtia bashkëshortore nuk njihet në këto male, ku gratë nuk mbajnë perçe e shkojnë e vijnë lirisht, gjë që është tepër e rrallë për të gjithë Shqipërinë. Edhe më të përvuajturat mes tyre, ruajnë një qëndrim, një dinjitet në ecjen e tyre, që zakonet tona perëndimore tashmë e kanë harruar prej kohësh... Këtë gjë vë re edhe Johan Georg von Hann, në veprën kur shkruan: ... "Për karakterin e pastër, domethënë jo të degjeneruar, të raporteve seksuale, dëshmon gjithashtu edhe fakti që si vajzat e krishtera ashtu edhe ato muhamedane, deri në kohën e martesës së tyre, qëndrojnë pranë deleve të tyre, ku gëzojnë një siguri të plotë në kuptimin absolut të fjalës. Sipas thënieve të njëzëshme, për çartjen e kurorës aplikohet dënimi me vdekje dhe si rregull ky duhet të vihet në jetë nga farefisi i fajtorit. Megjithatë, me gjithë pyetjet e shumta të bëra nga ana ime në vendet nga më të ndryshme, unë nuk qeshë në gjendje të identifikoj qoftë edhe një rast të vetëm konkret" Po ky autor për martesat dhe dasmat e tyre do të vinte re; .. "Nusja udhëton për në shtëpinë e burrit të saj të ardhshëm ku ajo do të bëjë një jetë të vërtetë skllaveje, e hipur mbi kalë dhe e shoqëruar vazhdimisht me të shtëna pushkësh, duke qenë e mbështjellë krejtësisht nga një pallto, që tek muhamedanët ka ngjyrë të kuqe kurse tek të krishterët ngjyrë manushaqe. Përsa i përket zakoneve specifike të martesës unë mora vesh, që në Bishkas, mbas ardhjes së nuses, dy burra me një bukë në dorë hipin mbi çatinë e shtëpisë ku zhvillohet dasma, hanë atje një pjesë të bukës, duke bërë urime për martesën e re dhe mandej bukën e mbetur e hedhin nga çatia në tokë." Elena Gjika (Dora D'Istria) vë re për martesat që bëhen në Shqipëri, shkruan për shumë ceremoni të cilat përgjithësisht bëhen si shenj e nënshtrimit që duhet të ketë gruaja në shtëpinë e burrit. Midis të tjerave ajo shkruan Martesa s'është gjë veç një blerje, ku vlera në familjet e pasura shlyhet me ushqime, ose kokë bagëtish. Njerëzit e thjeshtë të popullit japin për një grua rreth një dhjetë frangëshe. Ka mënyra të tilla për të luajtur me çmimet e kësaj shitjeje, sa që shpesh prindërit nuk druhen aspak të fejojnë bijat e tyre që në djep. 12 vjeçare ato janë pothuaj të gjitha të martuara. Fejesat dhe dasmat janë shumë të komplikuara tek të krishterët e Shqipërisë për shkak të një shumice ceremonish simbolike, të përcaktuara që t'i japin të kuptojë gruas detyrimet dhe sidomos inferioritetin e saj. Paule Fercoq de Leslay që ka parë një dasmë në Lurë vë re: .."Nga të gjitha anët mbërrinin të fejuar mbi kuaj, mbuluar me duvak të kuq. Ajri tundej nën krismat e pushkëve. Në çdo shtëpi që kaloja më luteshin e më ftonin që të qëlloja edhe unë. Nuset që qëndronin disa ditë të pa lëvizura dhe me sytë përdhe për ta parë miqtë dhe krushqit ajo i cilëson si martire të pagoja" Konsulli francez në Shkodër, A. Degrand në librin "Kujtime nga Shqipëria e epërme", Shkodër 2001, përshkruan : ..... në këto kushte s'mund të bëhet fjalë për martesa më pëlqim; autoriteti atëror, ende i palëkundur në këtë vend, vendos vetë për gjithçka. Shkuesi është një mik i familjes , pasi prindërit japin fjalën e fundit, babai njofton vajzën se e kanë fejuar. Vjehrra e ardhshme, e për më tepër dhëndëri, nuk e shohin vajzën deri në ditën e dasmës, në kishë" "Kur babai e lajmëron vajzën se e ka fejuar, ajo duhet të bëjë sikur është thellësisht e dëshpëruar; nëna i jep një palë uratë të dërguara nga burri i ardhshëm si provë e fejesës; babai ikën nga dhoma ku ajo ka kaluar vite të pafundme, kështu ai nuk duhet ta shohë tre ditë me radhë. Duhen shumë muaj, madje edhe një vit para se të bëhet martesa; të fejuarit, i cili gjatë gjithë kësaj kohe nuk do ta shohë nusen e ardhshme, i duhet kohë për rregulluar një dhomë në shtëpinë ku jeton bashkë me prindërit. Nga ana e tyre, prindërit e vajzës i kanë porositur kostumet e qëndisura që i përkasin rangut të familjes së tyre. Martesat në Shkodër De Grand, i përshkruan mjaft hollësisht, duke treguar ditët se kur katolikët dhe myslimanët i bëjnë dasmat, se si vajzat e reja, që nuk janë për martesë i kalojnë këto ditë të gëzuara, duke kënduar, gatuar, duke lyer gishtat dhe flokët me këna. Tregon për ndrikullat që shoqërojnë nuset, për arkën e nuses, për dhuratat që burri i dërgon nuses që deri ditën e dasmës nuk e ka parë, si dhe për shumë ceremoni të tjera të ditës së dasmës nga ku bën edhe dallime në mes katolikeve dhe myslimanëve. Aty shpjegohen edhe shumë tradita post-dasmë, sjelljen që i imponohet nuses brenda disa rregullave sipas zakoneve tradicionale. Po kështu e dhe Johan Georg von Hann, kur viziton Rizën, që është krahina e Rrëzës në anën e Tepelenës e të Delvinës, në veprën, përshkruan me hollësi zakonet e kësaj krahinë si të fejesës ku vajzat fejohen që në djep, që ato blihen nga familja e dhëndrit, që përbën shkakun kryesor midis pabarazisë në mes gruas dhe burrit. Në zakonet e dasmës, gjatë përshkrimit të ceremonialit ai tregon në çdo detaj pozitën nënshtruese të gruas, kurse kur përshkruan lidhjet familjare analizon respektin që është e detyruar të ndjekë gruaja në familje ndaj vjehrrive, kunatave, respekt ky që ia kalon atij ndaj bashkëshortit. Konsulli francez në Shkodër, Hecard shkruan: ... "Fati i një vajze të re malësore varet plotësisht nga babai dhe vëllezërit e saj; ato e përdorin sipas qejfit të tyre; atyre vijnë t'ua kërkojnë për martesë. Janë po këto që bëjnë pazarin, pa e pyetur vajzën aspak , dhe caktojnë se çmim për dhënien e pëlqimit të tyre, një shumë që varion nga 500 deri në 800 piastra turke (100-175 franga) sipas emrit ose rangut të familjes së tyre." Edhe Johan Georg von Hann, tregon për blerjen e grave: .. "Po ashtu si Greqia e lashtë antike, edhe Mati i sotëm "shkon i armatosur dhe blen gratë e tija". Në këto vende çmimi mesatar për një virgjëreshë është 3.000piastra, ndërsa për një vejushë të re kushton sa gjysma e këtij çmimi. Megjithatë kryepeshkopi i sotëm mbas një lufte të gjatë, ka arritur ta zhdukë këtë zakon barbar tek katolikët. Dhëndëri katolik është i detyruar të paguajë vetëm kostumin e nuses, për të cilin është caktuar njëherë e përgjithmonë që shpenzimet të kapin shumën prej 850 piastrash." Për jetën brenda shtëpisë së burrit Noëlle Roger vë re: ...Motrat dhe nuset jetojnë pranë njëra tjetrës, rrisin së bashku fëmijët e vegjël rreth nënëmadhes. Jeta e tyre rrjedh pa dëshira midis bashkëshortit, fëmijëve, vëllezërve, zanatit familjar dhe kopshtit të bukur rrethuar me mure. Traditat e vjetra bëjnë ligjin"... Hugo Adolf Bernatzik në librin "Shqipëria vendi i shqiptarëve", botuar në Tiranë më 2003 në mes të tjerave shkruan: ...megjithatë gruaja për një shqiptar është prona më e mirë dhe më me vlerë e tij.....Edhe në zonat e krishtera, nusja dhe dhëndëri nuk njihen para dasme, fejesa është një çështje e familjes, e pakthyeshme në këshillin e fisit-edhe për viktimën e politikës së familjes ku vendos për pranim ose refuzim vetëm fisi. E mbuluar me vello, nusja i dorëzohet dhëndrit, i cili e çon atë në shtëpinë e prindërve të vet dhe që nga ai çast ato jetojnë së bashku. Prishja e martesës çon menjëherë në gjakmarrje, po kështu edhe refuzimi nga ana e nuses i kontratës së mbyllur. Marrëdhëniet jashtëmartesore të çdo lloji sigurisht që janë përjashtuar nga norma të tilla morale.....Por, pothuajse kurrë dhënia e një vajze të re nuk bëhet para martese. Edhe nëse vajza i jepet pasionit, duke harruar kështu edukimin e hekurt dhe kjo vihet re nga të tjerët, atëherë babai i saj e vret me duart e tij.....Bashkëjetesa e e nuses me vjehrrën është shpesh një grindje e vazhdueshme për ekonomitë e reja të shtëpisë. Por ndarja nuk shihet me sy të mirë. Edward Lear në përshkrimin për martesat në udhëtimin e tij vë re: .. "Ja pra edhe mblesëritë e volitshme që sundojnë në këtë vend- martesat me shkuesi të bëra nga prindërit e çiftit, pavarësisht nga dëshira e dy individëve që janë personat më të interesuar për çështjen. Mospranimi i nuses nga dhëndëri, kur këtë ja sjellin deri në shtëpi, është diçka për të cilën familja nuk ta fal" Në librin "Dasma në Shqipëri" të Abaz Dojakës, janë dhënë në mes të tjerave edhe karakteri i lidhjeve martesore para dhe mbas çlirimit si dhe ceremoniali i dasmës". Për martesat para 1944, ai shkruan, se martesat ishin marrëveshje midis dy familjeve pa pyetur të interesuarit, dhe që sillnin forcimin e pozitës së tyre dhe shtimin e pasurisë, kurse në zonat malore martesat bëheshin sipas normave të së drejtës zakonore. ... "Sipas kanunit të Lekë Dukagjinit tagri për martesë i vajzës që edhe në qoftë se nuk kishte prindërit –ishte në dorë të vëllezërve e të kushërinjve. Vajza do të shkojë për atë të cilën e fejojnë" Lidhjet martesore mbas çlirimit ai i ndan në dy faza. Faza e parë nga 1944 dhe deri më 1965, ku futen koncepte të reja të lidhjeve martesore bazuar në ndryshimin e sistemit ekonomik, por që vazhdojnë të ruhen disa tradita të vjetra të bazuara në normat e të drejtës zakonore (veçanërisht në zonat malore) dhe faza e dytë nga 1965 deri në 1990, ku mbas fjalimit të E. Hoxhës në vitin 1967, synohet të thyhen dhe zhdukën normat e vjetra patriarkale, fetare: si fejesat në djep, blerja e nuseve, pajat e kushtueshme të vajzës, ceremonitë e ngarkuara e të tjera, që natyrisht arritën që të ndryshojnë edhe këto lidhje martesore..

- Profesore Zenepe Dibra

Ku gabojnë prindërit në edukimin e fëmijëve?

Nga SABA LAMA

Jeta gjithnjë ka vërtetuar se dashuria e ç'do prindi për fëmijën e tij, është aq e madhe sa nuk njeh limite. Jo pa qëllim thuhet që fëmija sado që mundohet të j'a shpërblejë prindit të tij për atë që ka bërë për fëmijën, është e kotë të mendosh se fëmija arrin të j'a shpërblejë prindit. Por sigurisht për prindin nuk është e lehtë për të arritur dëshirën e madhe që pretendon lidhur me sukseset dhe lumturinë që mendon të arrijë fëmija pas daljes në jetë, pasi vetë jeta e çdo njeriu në trajektoren që përshkon ka sfida të paparashikuara. E në këtë drejtim (krahas të tjerave), një rol të rëndësishëm për mbarëvajtjen e suksesshme të jetës së fëmijës, luan edhe trajtimi dhe edukimi që merr fëmija nga prindi, në mosha të ndryshme të rritjes së tij, deri sa të dalë në jetë dhe të bëhet zot i vetvetes. Jo pa qëllim prindi nga ekspertët e pedagogjisë dhe psikologjisë, është vlerësuar si mësuesi i parë i fëmijës, krahas mësuesve më të cilat përballet më pas fëmija gjatë cikleve të ndryshme të shkollimit. Në rrugëtimin e edukimit të fëmijës nga prindi (për pjesën që i takon për t'u bërë dikush nesër kur të dalë në jetë), nisur nga praktika përballemi edhe me dukuri që flasim për keq edukim të disa prindërve ndaj fëmijëve (ndonëse ata me praktikat që reflektojnë, mendojnë se janë të suksesshëm për arritjen e qëllimit që kanë). Pa dyshim këto dukuri që flasin për keq edukim, kanë të bëjnë me mungesën e kulturës, formimit, nivelit dhe mentalitetit të vetë prindit që bëhet fjalë. E pikërisht kjo është edhe arsyeja, që prindërit gabojnë në procesin e edukimit të fëmijëve, gabime të cilat sjellin edhe pasoja serioze në të ardhmen e fëmijës lidhur me objektivat për jetën e tij, më pas edhe te vetë prindit për fatet e fëmijës. Por lind pyetja, ku gabojnë prindërit në drejtim të edukimit të fëmijëve të tyre? Le t'i ndjekim dukuritë në vijim që përbëjnë edhe fokusin e këtij shkrimi të radhës:

1-Në përkëdheljet e tepruara nga prindi në raportet që ndërtojnë me ta (me fëmijët). Është fjala për plotësimin e dëshirave dhe kërkesave të tepruara të fëmijëve, madje edhe që kanë kosto të larta financiare, bie fjala: celularë, makina luksoze si dhe veshje apo dhurata të tjera në treg mjaft të kushtueshme).

2-Në mos angazhimin e tyre në punët apo detyrimet familjare (sipas mundësive dhe moshës që kanë). Por mos harrojmë se kontributi për familjen lidhur me detyrimet që i takojnë fëmijës sipas mundësive që ka, i shkërbenë mire edukimit për jetën e tij në të ardhmen.

3-Gjunjëzimi i prindërve ndaj fëmijëve të tyre, në rastet kur fëmijët i kundërshtojnë prindërit nga kritikat e drejta që u bëjnë. Në këtë drejtim kemi mjaft prindër, që ndonëse janë koshient se kritikat që u bëjnë fëmijëve janë të drejta lidhur me gabimet që bëjnë përmes sjelljeve të tyre, pranojnë të nënshtrohen, që padyshim ky nënshtrim ka pasoja negative në drejtim të edukimit të fëmijës në të ardhmen.

4-Mbrojtja e padrejtë e fëmijëve nga prindi. Bie fjala kur mësues apo individë të tjerë të shoqërisë, ankohen për sjelljet dhe dukuritë negative të fëmijëve që bëhet fjalë. Pra është fjala për rastet kur prindi nuk pranon të metat dhe mangësitë e fëmijës së tij, kur ua vënë në dukje të tjerët.Një dukuri e tillë nisur nga praktika, është reflektuar më tepër tek prindërit që kanë poste dhe pozita të rëndësishme shtetërore. Madje për mospranimin e të metave dhe mangësive të fëmijëve të tyre, prindërit e kësaj kategorie, në mjaft raste kanë reflektuar me gjuhën e arrogancës, krenarisë së tepruar dhe krekosjes absurde ndaj atyre që i kanë kritikuar fëmijët e tyre.

5-Në reflektimin e dhunës nga prindi gjatë procesit të edukimit të fëmijës, kur ai (prindi), është ndjerë i mërzitur gjatë përballjes me gabimet e konstatuara. Por dua të nënvizoj se në raste të tilla, bëhet e nevojshme dhe e domosdoshme, që prindi të jetë i përmbajtur, i matur dhe i ekuilibruar në debatin e zhvilluar, me qëllim që të arrijmë ta bindim fëmijën për gabimin apo sjelljen që bëhet fjalë. E pikërisht kur prindi arrin ta bindi fëmijën e tij për gabimin e bërë apo sjelljen jo të hijshme të reflektuar nga ai, është edhe kyçi i suksesit në procesin e edukimit, pasi dihet që rruga e edukimit përmes reflektimit të dhunës, edukon të fëmija në të ardhmen vetëm dhunë dhe sjellje të agresivitetit e kapriçiozitetit në raportet me anëtarët e familjes së tij. E sigurisht për një sjellje të tillë nga fëmija, si shkak dhe model për keq, është bërë vetë prindi i fëmijës që bëhet fjalë në procesin e edukimit të fëmijës. Por dua të nënvizoj se këta prindër për këtë keq edukim që kultivojnë ndaj fëmijëve të tyre meritojnë t'u thuash shprehjen e njohur në zhargonin popullor: "Në këtë jetë çfarë do mbjellësh atë produkt do të korrësh". Pra dhe ju, po korrni atë që keni mbjellë tek fëmija juaj nga keq edukimi i bërë ndër vite. Jo pa qëllim thuhet që fëmija është pasqyrë e prindit në mënyrat e sjelljes së tij. Sigurisht ky keq edukim i fëmijës nga prindi, manifestohet dhe rëndon jo vetëm te anëtarët e familjes se tij, por edhe në ambientet e jetës së përditshme sociale sipas rasteve.

6-Në mosinteresimin e prindit për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë. Në këtë drejtim ka rezultuar se prindërit vijnë në shkollë vetëm 2 herë në vit për të mare rezultatet semestrale apo rezultatin përfundimtar vjetor ose kur mësuesit i thërrasin kur organizojnë takime me prindërit e nxënësve, madje edhe në tilla raste ka prindër që nuk paraqiten në shkollë. Por mos të harrojmë faktin se nëse nuk funksionon komunikimi apo trinomi pedagogjik mësues-nxënës-prind apo familje, nuk mund të ketë rezultate të mira në shkollë nga nxënësit. Kjo shkëputje fizike, emocionale dhe komunikuese mes prindit dhe fëmijës krijon një boshllëk të pazëvendësueshëm.

7-Në respektimin e të drejtave të fëmijëve për pjesën që u takon dhe jo t'u kërkojmë apo t'u imponojmë atyre një jetë të mbyllur e të izoluar, pasi fëmija ka nevojë të njohë të mirat dhe të këqijat e jetës dhe ambientit ku rritet dhe edukohet.

8-Në mos përfshirjen e fëmijës nga prindi, për t'u rrëfyer dhe për të qenë i hapur për problemet që ndjenë dhe e shqetësojnë atë. Sigurisht ky aspekt përbën një tjetër qasje të gabuar në drejtim të edukimit, pasi është një ndrydhje dhe një dhunim për fëmijët në kuadrin e respektimit të të drejtave që i takojnë.

9-Në gjirin e prindërve, kemi edhe nga ata prindër që i edukojnë fëmijët e tyre që kur të rriten të bëhen të pasur, por për lumturinë dhe mirësinë e jetës kur të rriten, duhet t'i edukojmë ata (fëmijët), duke ditur së pari vlerat e gjërave që e bëjnë në jetë të lumtur dhe jo çmimin që sigurojmë apo përfitojmë. Në jetë, janë disa gjëra që nuk blihen me para (vlerat dhe virtytet, rregullat dhe parimet e jetës, empatia, e të tjera, por që ndikojnë në formimin e personalitetit të fëmijës. Jo pa qëllim përdoret shprehja e njohur: "Nuk të bën leku zotëri por sjellja".

10-Në mbivlerësimin e vlerave apo meritave të fëmijës. Në këtë drejtim, kemi edhe prindër që i mbivlerësojnë meritat që ka fëmija i tij, por edhe një dukuri e tillë e keq edukon fëmijën pasi i krijon atij prirjet e dëlirit, mendjemadhësisë, kapriciozitetit dhe superioritetit në raportet me të tjerët, duke menduar se është i pagabueshëm dhe i pakritikueshëm sa herë jep mendime për një problem të caktuar. Edhe raste të tjera që duhen vlerësuar si model i keq, nga vetë prindi në drejtim të edukimit të fëmijëve :a) – Kontaktet e prindit me pijet alkoolike, duke arritur në pika kulmore gjatë përdorimit të tyre që sjellin si pasojë gjendjen e dehur të tij dhe sjelljet jo normale kur vjen te familja e tij.

11-b) – Kontakti i tij me elementë që njihen për qëndrime dhe sjellje problematike në shoqëri.

12-c) – Zhvillimi i debateve dhe i zënkave nga vetë prindërit në sy të fëmijëve nga mosmarrëveshjet dhe konfliktet e lindura në marrëdhëniet midis tyre, ku në këtë drejtim pika më kulmore e sjelljes negative është rasti kur burri dhunon partneren e tij, në sy të fëmijës së tij. Por mos harrojmë se ky akt, ndikon negativisht në psikologjinë dhe emocionalitetin fëmijës.

ç) – Qëndrim jo i njëjtë i prindërve në raport me fëmijën, kur ky i fundit ka gabuar përmes sjelljes së tij. Ky qëndrim i tillë sigurisht e dëmton shumë fëmijën, pasi fëmija jo vetëm që është i prirun për t'a përsëritur të njëjtin gabim, por për të manifestuar edhe gabime të tjera në të ardhmen nga mos gjetja e një gjuhe të përbashkët të prindërve apo bashkëshortëve lidhur me qëndrimin që duhet mbajtur në rastet kur fëmija përmes sjelljeve të tij në familje apo ambiente të tjera sociale gabon.

1-d) – Fjalori banal që përdorin disa prindër në sy të fëmijëve, sigurisht përbën një tjetër dukuri që ndikon negativisht në drejtim të edukimit të fëmijës së tij. Në kuadrin e mire edukimit të fëmijëve nga prindi, ç'do prind duhet ta ketë të qartë se sfidat për arritjen e suksesit, duan edhe përkushtim, durim, takt dhe maturi nga ana e prindit, krahas kulturës dhe horizontit të tij. Është pikërisht kjo arsyeja që nga ky keq edukim, shumë prindër përballë sfidave të jetës së sotme, e kanë pranuar dështimin në edukimin e fëmijës së tyre. Së fundi dua të theksoj se fëmijët janë pjesë e familjes dhe e shoqërisë dhe nisur nga ky realitet, mirë edukimi që bëjnë prindërit për fëmijët, është një investim jo vetëm për fëmijën dhe familjen e tyre, por dhe një investim apo kontribut i vyer për shoqërinë dhe kombin që i përket, pasi dihet që familja është celula bazë e shoqërisë njerëzore.

Më 6 dhjetor 1689 vdiq imzot Pjetër Bogdani, ipeshkvi i madh shqiptar

Me 6 dhjetor 1689 vdiq në Prishtinë nga epidemia e murtajës personaliteti i shquar i Kishës e kulturës shqiptare, imzot Pjetër Bogdani. Ipeshkvi i madh shqiptar vlerësohet si teologu më i njohur shqiptar dhe figura më e ndritur e letërsisë së vjetër shqiptare.

Imzot Pjetër Bogdani (lindi rreth 1625 në Has - vdiq më 6 dhjetor 1689 në Prishtinë) - prift, ipeshkëv, kryeipeshkëv, teolog dhe filozof shqiptar nga Hasi (krahinë e lashtë), që shtrihet në Shqipëri dhe Kosovë.

Lindi në Gur të Hasit afër Prizrenit. Mësimet e para i bëri në Ciprovac, Bulgari.

Në vitin 1674 ishte nxënës i kolegjit ilirik të Loretos, po këtë vit bën një kërkesë për studimin e medicinës dhe për lëshuarjen e Kolegjit. Më 1651 ushtron detyrën e meshtarit në Pult e në fshatrat e Prizrenit, në anët e vendlindjes.

Në vitin 1656 thirret në Romë për të vijuar studimet e larta teologjike në Kolegjin e Propagandës së fesë. Aty i mëson gjuhët e Lindjes. Më 1658 kreu studimet e larta të teologjisë e filozofisë në Romë dhe mori titullin doktor. Pas një kohe veprimtarie e apostulli si meshtar, emërtohet ipeshkëv i Shkodrës dhe administrator i Tivarit. 1663–1664: Njihet dhe i bën shërbime Kardinal Barbarigos, i cili në atë kohë jetonte e punonte në Romë. Më 1675 e shkruan librin "Çeta e profetëve" dhe ia paraqet Kongregatës së Vatikanit Propagandës së Fidesë për botim. Rekomandimi i Propagandës ishte të përkthejë librin. Fillon përkthimin e librit.

Në vitin 1677 emërtohet Arqipeshkëv i Shkupit në vend të të ungjit, Ndre Bogdanit. Lufta turko–austriake fillon më 1683. Në dhjetor të atij viti vdes Ndre Bogdani. Bogdani arratiset në male me ç 'rast e humb librin e Gramatikës latinisht–shqip të punuar nga Ndreu. Strehohet në Ciprovac dhe në Dubrovnik. Në pjesën e parë të vitit 1685 shkon në Venedik e në Padovë. E merr me vete librin e përgatitur për botim.

Libri 'Cuneus Prophetarum' botohet në fund të vitit në Padovë te Barbarigo. Shkruan Relacionin e njohur nga Shkupi: Dello stato spirituale e temporale del regno di Albania e Servia (Mbi gjendjen shpirtërore e shoqërore të mbretërisë së Shqipërisë e Serbisë 1687–1688): Merret aktivisht me organizimin e rezistencës antiturke dhe u bën vizita të gjitha bashkësive kishtare në vende të Kryeipeshkëvisë së vet.

Në vitin 1689 depërton ushtria austriake. Në nëntor kjo ushtri arrin në Prishtinë. Bogdani niset me ushtrinë për Prizren, ku i inkuadron edhe 6.000 shqiptarë dhe bashkë me ta arrin atje. Atje sëmuret nga murtaja. Kthehet në Prishtinë për shërim te mjekët gjermanë, po më kot. Vdes në fillim të dhjetorit 1689 në Prishtinë ku edhe varroset. Siç njoftonte nipi i tij, Gjon Bogdani, menjëherë pas thyerjes së ushtrisë austriake ato ditë, tartarët dhe turqit e nxjerrin nga varri trupin e tij.

Vepra e ipeshkvit Pjetër Bogdani "Cuenus Prothetarum de Christo Salvatore Mundi" e njohur me titullin shqip "Çeta e Profetëve" shkruar në gjuhën shqipe dhe italiane. Ja edhe titulli origjinal i plotë: "Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi, et eius evangelica veritate, italice, et epirotice contexta, et in duas Partes divisa",botuar më 1685në Padovë. "Çeta e profetëve" (Cuneus prophetarum) u rishtyp më 1691 dhe 1702 në Venedik me titull të ndryshëm. Libri "Cuneus Prophetarum", apo sipas përkthimit të Justin Rrotës "Çeta e profetëve", është një nga veprat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë të vjetër letrare. Fakti që është e para vepër origjinale në gjuhën shqipe, në krahasim me veprat e autorëve paraardhës që ishin kryesisht përkthime, e bën tepër të rëndësishëm këtë libër.

Karakteri origjinal i veprës duhet marrë në mënyrë relative për përmbajtjen e karakterin fetar që kishte, por duhet thënë që nuk është mbështetur në ndonjë autor të caktuar në formë përkthimi. Tematika e larmishme i shton rëndësinë veprës. Aty gjejmë që nga tematika teologjike, biblike e filozofike, këndej fetare, tek historiografike, të shkencave të natyrës, por edhe letërsi artistike, poezi. Kjo larmishmëri temash çon edhe në larmishmëri stilesh, që është një tregues i shkallës së lartë të përpunimit të gjuhës për atë kohë. Dhe padyshim ky është një gur i rëndësishëm në themelin e gjuhës së sotshme shqipe.

Autori ka gjetur mundësi të shtjerë elemente të jetës shqiptare të kohës e të historisë së popullit tonë, si është rasti i qëndresës burrërore të kelmendasve kundër ekspeditës turke më 1639. Mendimet e njohuritë e ipeshkvit shqiptar, imzot Pjetër Bogdanit shpalosen më shkoqur në parathënien e librit dhe në relacionet e shumta, që hartoi pas vizitave apostolike e baritore në viset e dioqezave që ai drejtoi si bari shpirtëror.

Shkroi me dashuri të madhe për gjuhën shqipe, për Atdheun e për popullin shqiptar, shprehu dhembje për gjendjen e mjeruar e padijen, në të cilat i kishte hedhur robëria bashkatdhetarët e tij dhe kundërshtim të thellë për pushtuesin osman.

Imzot Pjetër Bogdani kërkonte që t'i jepeshin popullit shqiptar libra në gjuhën amtare, punoi për mëkëmbjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare dhe çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Vepra "Çeta e profetëve ka në krye një seri kushtimesh e poezish shqip, latinisht, italisht, sllavisht, shkruar për nder të Pjetër Bogdani nga miq e të njohur të tij. Dy vjershat shqipe të L. Bogdanit e të L. Sumës dhe ato të vetë autorit të shpërndara në kapituj të ndryshëm të librit, me teknikën poetike përgjithësisht të sigurt janë tregues të lëvrimit të mbarë të vjershërimit shqip në këtë kohë.

Imzot Pjetër Bogdani krijoi me vetëdije të plotë për ta pasuruar e përpunuar gjuhën shqip dhe popullin shqiptar me të vërtetat e fesë së krishterë e, gjurmoi dhe vuri në qarkullim fjalë e shprehje të vjetra të lëna në harresë, krijoi edhe fjalë të reja, duke bërë përpjekjet e para për krijimin e termave në ndonjë degë të shkencës si dhe në teologjik e në fjalorin kishtar në përgjithësi. Ligjërimi i tij dallohet mjaft herë edhe për zhdërvjelltësi e ndërtime sintaksore të një arkitektonie të sigurt.

Me veprat e imzot Pjetër Bogdani letërsia dhe gjuha letrare shqipe shënuan hapa të rëndësishëm përpara.

Përgatitur nga
DENIS ZAVALANI

Amerikanë dhe shqiptarë, bashkë në Luftë e në Paqe

Nga Sali ONUZI
Kolonel në pension, Drejtor i Departamentit të Veteranëve të Luftës në Ministrinë e Mbrojtjes më 1995-2001

Me rastin e 11 nëntorit, Ditës së Veteranit të Luftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Siç është e njohur gjerësisht në Shqipëri, me 11 nëntor Shtetet e Bashkuara të Amerikës kujtojnë, nderojnë dhe festojnë Ditën e Veteranit të Luftës. Ajo është një ditë e shënuar e sanksionuar me ligj, është ditë pushimi zyrtar, dhe ditë aktivitetesh te larmishme shtetërore dhe publike. Ajo tregon qartë se ç 'vlerësim të lartë kanë shteti dhe populli amerikan për Veteranët e Luftës.

Kjo ditë ka dhe një histori të sajën: 11 nëntori është dita e përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Prandaj kjo ditë e shënuar e fitores u kujtua në fillim më 1919 si ditë e armëpushimit dhe në vitin 1954 me një dekret të Presidentit, ajo u emërtua përfundimisht "Dita e Veteranit të Luftës'. Ajo është Ditë e veteranëve të të gjithë luftërave që janë zhvilluar në SHBA ose kanë zhvilluar ato nga Lufta për Pavarësi (lufta revolucionare amerikane- 1775-1783), Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, deri në luftërat e ditëve të sotme.

Në këto luftëra kanë marrë pjesë disa milionë ushtarë, oficerë amerikanë e punonjës civil, burra dhe gra të të gjithë kombësive që përbëjnë SHBA. Në SHBA veteran është një person që ka shërbyer në forcat e armatosura. Sipas një informacioni të 14 prillit 2025 në SHBA kishte 15.8 milionë veteranë të luftës e të ushtrisë. Gratë përbejnë 11.6 përqind të tyre. Gratë kanë shërbyer për më shumë se dyqind vjet në ushtrinë amerikane. Të gjithë veteranët e Luftës e të Ushtrisë nderohen në këtë ditë. Që nga Presidenti i SHBA, qeveria, Kongresi, dhe shtetet e federuara, Forcat e armatosura, universitetet dhe shkollat ,planifikojnë dhe zhvillojnë veprimtari përkujtimore, homazhe, koncerte, lojëra sportive, ekspozita e deri ulje çmimesh etj. Ajo përkujtohet me nderim të madh edhe nga trupat amerikane që ndodhen aktualisht në shërbim të lirisë e të paqes jashtë vendit të tyre.

Veteranët e Luftës në SHBA kanë pasur gjithmonë një status të lartë në shtetin dhe shoqërinë amerikane. Ky status i ka fillimet e tij historike që më 1865 kur presidenti Lincoln bëri thirrjen e famshme për t'i trajtuar mirë Veteranet e Luftës. Ky status , i përcaktuar me ligje të veçanta për veteranët e çdo lufte, përfshin si vlerësimin e lartë moral të tyre, aspektin juridik dhe atë social-ekonomik e kulturor si për ata që janë gjallë, por edhe për pasardhësit e veteranëve të rënë në luftë. Ky ligj u jep ushtarakëve amerikanë mbështetje ligjore dhe përfitime të caktuara. Si për shumë aspekte të tjera të jetës shoqërore e politike, ligji amerikan për veteranët e Luftës ka qenë dhe është një model, të cilit i janë drejtuar shtetet dhe vendet demokratike perëndimore. Pas rënies së sistemit monist në Evropën Lindore statusi i veteranit të Luftës u bë edhe këtu objekt i ligjvënësve dhe realitet.

11 nëntori përkujtohet si Ditë e Kujtimit edhe në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Komunuelthit Britanik me 1 minutë heshtje në orën 1100, ose duke mbajtur një lule të kuqe ose të bardhë në jakë. Vende të tjera demokratike kanë ditë të tjera për të përkujtuar e nderuar veteranët e Luftës ose të rënët e tyre në Luftëra.

Shqiptarët i lidh më këtë datë së pari roli i madh që kanë luajtur Shtetet e Bashkuara dhe veteranët e tyre në rojë të lirisë dhe të paqes në shekuj , dekada e vite. Por na lidhin edhe qindra djem e vajza shqiptare e me origjinë shqiptare ,që si qytetarë të këtij vendi të madh, kanë qenë efektiv të Ushtrisë Amerikane në luftëra, sidomos në Luftën e Parë dhe të dytë Botërore dhe mbi të gjitha në luftën për Çlirimin e Kosovës. Është tanimë aq e njohur dhe simbolike pilotja amerikane me origjinë shqiptare Faruza Haki Kallaba që mori pjesë në bombardimet 78 ditore në Serbi, uniforma ushtarake e së cilës ndodhet sot në një Muze të Kosovës. Ose shembulli i një batalioni vullnetarësh të shqiptarëve të Amerikës me emërtimin "Atlantik" që erdhi nga përtej Oqeanit dhe u fut në luftime si pjesë përbërëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ato ishin vazhdim i përvojës dhe traditës së shqiptarëve të Amerikës të cilët erdhën për të luftuar në Shqipëri pas fitores së Pavarësisë. Na lidh edhe kontributi i 13 oficerëve të misioneve amerikane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Simbol i kësaj lidhje u bë kapiteni Tomas Stefani, djalë i një shqiptari nga Korça, që kish ndërprerë studimet universitare dhe erdhi si shef i ndërlidhjes amerikane pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare. I bukur, i zgjuar, me një shqipe të qartë, Tomas Stefani u mirëprit edhe nga partizanët e thjeshtë shqiptarë. Për shkak të lidhjes me udhëheqësit e Ushtrisë NÇ (Enver Hoxha disa herë e mbante afër vetes në mbledhje) ngjalli edhe xhelozinë e oficerëve britanikë në Shqipëri. Tomas Stefani mori pjesë edhe në Kongresin e Përmetit, punimet e të cilit i ndoqi me vëmendje dhe për të cilat hartoi një raport, me të cilin fitoi shumë pikë në Shtabin aleat në Kajro.(siç dihet britanikët, me një akt kontrovers, nuk iu përgjigjën ftesës së Këshillit ANÇ shqiptar për të marrë pjesë në këtë Kongres te madh antifashist nacionalçlirimtar). Madje Tomas Stefani u martua edhe me një shqiptare të Tiranës që e mori me vete në SHBA.

Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, Spiro Moisiu takohet me Tomas Stafanin, shef i ndërlidhjes së misionit ushtarak amerikan në Shqipëri.

Na lidh gjithashtu kontributi i pilotëve amerikanë të Aviacionit aleat që realizuan në territorin shqiptar disa sulme kundër forcave gjermane, kundër autokolonave dhe garnizoneve të fortifikuara si në Tiranë e Dibër, ose ai pilotëve të avionëve "Dakota", që sillnin furnizime në Shqipëri për Luftën.

Me veteranët amerikanë na lidhe edhe shpëtimi në Shqipëri i 30 ushtarakëve amerikanë të mjekësisë (nëntor 1943-9 janar 1944), të cilët ranë aksidentalisht ne Çestije të Elbasanit dhe për 68 ditë nëpër Shqipëri nga Berati në Skrapar, në Korçë, në Përmet e Gjirokastër kaluan në bregdetin e Vlorës ku në gjirin e Gjongjilekës u imbarkuan në një anije britanike për në Bari.

Kudo grupi i amerikanëve qe pritur dhe ndihmuar miqësisht, duke sakrifikuar e vënë edhe jetën në rrezik (gjermanët i kërkonin dhe digjnin shtëpitë që i kishin strehuar). Për ta ishte njoftuar Presidenti amerikan Ruzvelt që kish urdhëruar të gjendeshin dhe shpëtoheshin për më tepër që 13 prej tyre ishin vajza infermiere ushtarake me gradë nëntogerë. Për këtë rast, komandanti amerikan i Lindjes së Afërme, gjenerali R. Roi shkroi një telegram falënderimi për popullin shqiptar. Me rastin e 80 vjetorit të Çlirimit, "Dritare TV" me producente Rudina Xhungën realizoi dokumentarin "Në besë të shqiptarëve" kushtuar pikërisht shpëtimit të grupit të ushtarakëve amerikanë në Shqipëri, përurimi i të cilit u bë në Kryeministri në prani të kryeministrit Rama,

Pjetër e Bibë Vatnikaj (të Mërturit) - misionarë të paqes

Pjetra dhe kontributi i tij

Siç duket e siç tregon përvoja jetësore jo vetëm e traditës shqiptare, por edhe botërore-vendlindja kurdoherë është burim frymëzimi e dashurie, është një oaz që të tërheq si me magji për t'u çlodhur e për t'u vetë rrëfyer për jetën tënde e pse jo, edhe për të dhënë "llogari" se sa ke bërë e sa e ke kryer detyrën ndaj saj.

Edhe unë siguristh, se jam i përfshirë në këtë magji e vitet e fundit gjithnjë e më shumë po më shtohet malli për atë vend ku linda e u rrita, ku eca këmbëzbathur e renda brigjeve të lumit e thepave të bjeshkës së Kores së Mërturit.

Si bashkëfshatarë, shpesh më ka rastisë të takohem me vëllezërit Vatnikaj, Pjetrin e Bibën (Bacin), që nuk i kanë braktisur asnjëherë trojet e të parëve, por kanë jetuar mes Shkodrës e vendlindjes.

Pjetri, deri sa dha frymën e fundit në vitin 2022, pothuajse qëndroi gjatë gjithë kohës (përjashtuar rastet kur misioni i tij e thërriste për çështjen e madhe së cilës i ishte përkushtuar) në atë shtëpi, simbol i harmonisë, mikpritjes e thjeshtësisë, me



shumë histori, e shquar për mençuri e kontribut shoqëror. Emri i njohur i Tunxh Myftarit, dikur të një oxhaku me vëllezërit Vatnikaj, nuk u rrit nga pasuria, as nga sarajet shumëkatëshe e prona të paana, por, kontributi shoqëror në dobi të komunitetit, e lartësoi shumë më shumë se sa po të kishte ato që përmenda në përmasa shumë të mëdha. Patriot me integritet, me të përpjeta e tatëpjeta, por gjithnjë në krye, i lartësuar e nderuar në të gjitha kohët e gjitha shtresat, ndonëse pati edhe shumë peripeci

e privacione personale e familjare;

dha frymën e fundit në fshatin e tij, por familja iu përndoq e u shpërnda nga regjimi si zogjtë e korbit.

Ajo shtëpi Kala nuk do të shuhej, por do të lindte filiza, flamurtarë të rinj e veprën e tij do ta çonte përpara dega tjetër Vatnikaj -shtëpi e Nosh Ujkës, kushëri i afërt, të një zjarrmi e të një votre; i ra barra Pjetër Noshit, një barrë e madhe dhe e rëndë në atë sistem të egër që kërkohej më shumë mjeshtri se sa trimëri, për të vazhduar e përjetësuar veprën e një burrë siç ishte Tungj Miftari. Po due me shprehë konkluzionin qysh në fillim, se radhë kush mund ta kishte kryer më mirë këtë detyrë, se sa Pjetër Noshi, duke ruajtur e rritur emrin e tij pas Çlirimit, i cili edhe mund të groposej në atë sistem, që nëpërkëmbi, mohoi dhunshëm e groposi persona e familje të nderuara, që bëjnë historinë e kombit. Me mençurin e frymën toleran-te, me mjeshtri e kujdes ruajti këtë figurë madhore, jo me gjoks e karshillek, por me elegancë e ura komunikimi deri në atë shkallë sa emri i Tungjit nuk ishte sakrilegj të përmendej edhe nga pushtetarë, por jo radhë të përdorej edhe për referencë pozitive.

---

ish-Presidentit Moisiu, ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu, përfaqësuesve të Ambasadës amerikane, pjesëtarëve të familjeve që pritën, strehuan e shpëtuan grupin e ushtarakëve amerikanë dhe plot të ftuar.

Odiseja e tyre drejt lirisë në Shqipëri është bërë pas lufte objekt e subjekt i medias, i letërsisë , kinematografisë , botimeve, vlerësimeve të larta. Disa prej tyre prehen në varrezat kombëtare në Arlington. Me popullin shqiptar veteranët amerikanë të luftës i lidh përjetësisht kontributi i tyre i madh në Çlirimin e Kosovës që nga gjenerali i madh Wesli Clark, nga diplomati trim Willian Worker , te pilotët dhe ushtarakët që u angazhuan kundër ushtrisë pushtuese serbe. Ushtarakët e SHBA edhe sot janë efektivë të KFOR në Kosovë në bazën e tyre të madhe "Bonsfilld". Siç janë të pranishëm në Shqipëri në stërvitjet e NATO-s.



Faruza Haki Kallaba, majore, pilotja amerikane, me baba shqiptar, që mori pjese në 30 aksione në Luftën e NATO-s, në Jugosllavi,1999.

Edhe në Shqipëri e Kosovë vitet e fundit festohet Dita e Veteranit të Luftës Nacionalçlirimtare (në Shqipëri) dhe e Veteranit të Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë. Kuvendi i Shqipërisë më 2019, caktoi datën 20 korrik si Ditë të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare,(datë e krijimit të Organizatës së Veteranëve të Luftës më 1957), kurse në Kosovë kjo ditë është caktuar me 30 dhjetor, si dita e 30 dhjetori 1991 të ndeshjes e të fitores së parë të Adem Jasharit kundër forcave serbe.

Më parë në Shqipëri pas Çlirimit për 47 vjet (1945-1992) gjithë populli dhe shteti përkujtonin e nderonin veteranët e Luftës dhe të Ushtrisë më 10 korrik, e përcaktuar atëherë si dita e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe e Ushtrisë Popullore.

Dy nga Veteranët e Luftës se Dytë Botërore që kanë luftuar në Shqipëri (Agnes Jensen Marhgarich dhe Lloyd Smith) kanë qenë në vitet 1995-6 për vizita, janë pritur në Ministrinë e Mbrojtjes dhe janë takuar e kanë biseduar më veteranë të Luftës, madje kanë vizituar edhe vendet ku kishin qenë në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Mikpritja e tyre ka qenë tipike shqiptare. Agnes Jensen 83 vjeçe iu thoshte vajzës dhe djalit të saj që e shoqëronin, se Shqipëria është atdheu im i dytë. Menjëherë pas vizitës këtu, ajo botoi në SHBA kujtimet e saj për kohën e Luftës në Shqipëri. E ftuar nga Sekretari amerikan i Mbrojtjes, William Perry në 50 vjetorin e Planit "Marshall" ajo ishte mrekulluar kur Sekretari i përmend emrin e saj si Veterane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe si një Veterane e Luftës se Popullit shqiptar, dhe i tregonte sallës, që duartrokiste, Librezën e Nderit të Veteranes së Luftës Nacionalçlirimtare që i kishte akorduar Ministria e Mbrojtjes se Shqipërisë. Një përmbledhje e kujtimeve të Agnes Jensen për " aventurën shqiptare" është përfshirë në një botim prestigjioz amerikan ku janë botuar kujtimet e heronjve të mëdhenjtë të SHBA në Luftën e Dytë Botërore, së pari të Presidentit Geoge Bush, ish pilotit Hero të kësaj Lufte.

Ndërsa Lloyd Smith, ish-kapiten i zbulimit amerikan në Himarë më 1943-44, në njërën nga shtëpitë e kohës së luftës tregoi se aty i kishte shkrehur pa dashje në tavan një armë që ia kish dhënë për ta parë i zoti i saj. Po , i tha mikpritësi shqiptar, ja tek është vrima e plumbit. E kishin ruajtur për 52 vjet. Atëherë Smith ngrihet në këmbë e përqafon të zotin e shtëpisë i përmalluar. Kur u kthye ne Tiranë thoshte se tani u binda që më keni çuar tamam në shtëpitë ku kam qenë në kohë të luftës.

Dua të kujtoj edhe vizitën e delegacionit të Departamentit të SHBA për Çështjet e veteranëve të Luftës (ai është një ministri si gjithë ministritë e tjera të kabinetit me një buxhet kolosal) në vendin tonë. Ata kishin kaluar në gjithë vendet e Evropës lindore për të dhënë përvojën e tyre për veteranët e Luftës. Të prirë nga drejtoresha e Washingtonit ata u pritën në Ministrinë e Mbrojtjes ku u njohën me ligjin për Statusin e veteranit të Luftës dhe me praktikat e procedurat për dhënien e tij. Që ato ditë u vendosen lidhje të rregullta me Departamentin e SHBA për Çështjet e Veteranëve të Luftës.

Me këtë ditë të shënuar të 11 nëntorit, Veteranët e Luftës ANÇ të popullit shqiptar dhe pasardhësit e tyre, po edhe gjithë populli shqiptar, kujtojnë me respekt Veteranët Amerikanë të Luftës dhe kontributin e madh të tyre për SHBA e Botën dhe veçanërisht për Shqipërinë e Kosovën dhe iu urojnë atyre jetë të gjatë e shëndet!

Më thoni mua kush më mirë mund ta kryente këtë mision zemre (disi i pamundur) se sa Pjetër Noshi? Besoj se janë të një mendje me mua të gjithë ata që e kanë njohur nga afër e parë veprimtarinë e tij shumë vjeçare. Mos mendoni se ka qenë e lehtë edhe pas viteve '90... Kanë qenë prova e sprova të vështira, dështmitarë të cilave jeni edhe ju...

Unë kam një jetë të tërë marrëdhëniesh harmonie e mirëkuptimi me këtë familje (si i gjithë komuniteti i krahinës), por disa gjëra i di, disi më mirë, se kemi qenë në marrëdhënie më të afërt, shumë prej tyre i kam patur nxënës e më vonë bashkëpunues për probleme të ndryshme, ortakë në stan e me djemtë e vëllait janë tezakë...

Me maturinë, qytetarinë e fisnikërinë që e karakterizonte, kur zhvillimet shoqërore e problemet e shumta që lindën pas viteve 1990, thirrën në skenë edhe përfaqësuesit e pasardhësit e familjes së Tunxh Miftarit, Pjetër Noshi, me qytetarinë e fisnikërinë që e karakterizonte, u takua me titullarët e asaj familje e me përfaqësues të brezit të ri...

Kur takohen burrat e kur manifestohet fisnikëria e mirëkuptimi, zgjidhjet nuk janë të vështira...Në nderim të aftësive e kontributit të familjes, të ruajtjes e ripërtëritjes së atij trolli me emër nga Pjetër Noshi e vëllezërit e tij, duke i shprehur falënderime e mirënjohje të thellë, këtë nderim e peshë të rëndë ua besuan kësaj familje dikur të një votre, që do të përfaqësohej nga Pjetër Noshi. Disa gjëra duken interesante e shpesh historia ka pikëtakime domethënëse. Pas disa kohësh, kur u nda nga jeta Pjetër Noshi, nga Komuniteti e organizmat e Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar, kërkohej edhe kontributi, vazhdimësia e përfaqësimi i kësaj familje. Tradita familjare është një

vlerë e pazëvendësueshme... Me shumë qytetari e zemër plotë, Sokol Pjetra, i lutet e i kërkon xhaxhait Bibë Noshi, të angazhohet rregullisht në këtë Mision të madh, madje, edhe duke e falënderuar për kontributin e dhënë të deriatëhershëm... Mes te tjerash shprehet "Do ta di për nder, mbasi ke më shumë kohë e mundësi...". Ky djalë ka gëzuar e gëzon një respekt të madh për vlerat që ka, madje kohët e fundi t e kanë zgjedhur njëzëri Sekretar të Përgjithshëm të Pajtimit Mbarëkombëtarë...Pjetër Noshi ka lënë një trashëgimi të vyer shoqërore, djali i tij është një pasuri e madhe me shumë cilësi pozitive, jo vetëm për familjen, por edhe për shoqërinë.

Baci - me një jetë aktive dobiprurëse

Me mbarimin e shkollës 8-vjeçare në fshatin e lindjes, në vitin 1969, Biba, 16-vjeçar, largohet për në Gri, një qytezë punëtorësh e një kantier ndërtimi.

Punon kryesisht në H/C e Fierzës, në fronte të ndryshme, madje edhe në ato më të vështirat, duke u aftësuar edhe si mjeshtër.

Krahas punës, gjatë këtyre viteve, mbaron edhe Shkollën e Mesme pa shkëputje nga puna. Janë afër 20 vite punë e përvojë, në fronte e kolektiva të ndryshme, duke kontribuar pa u kursyer me një pagë modeste, por, pa i shkëputur asnjëherë lidhjet e ndihmën për familjen e fshatin ku lindi e kaloi vitet e adoleshencës. Këto dy dekada janë edhe vite të rritjes e pjekurisë, të një formimi të admirueshëm e respekti të merituar, mbështetur në punën e sjelljen e tij, në marrëdhëniet e shëndosha me punëtorët e personelin teknik e administrativ të çdo kantieri. Në këto vite ka parë e gjykuar edhe për shumë probleme, që nuk

po ecnin në atë sistem të ashtuquajtur socialist, prandaj, qysh në vitin 1990, përkrahu e kontribuoi pa mëdyshje për lëvizjen demokratike të kohës e ndryshimet me frymë perëndimore.

Në fillimin e viteve '90 u stabilizua familjarisht në Shkodër e punoi disa vite në organet e Policisë së Shtetit, Komisariati Shkodër.

Kur punoi në organet e policisë, u shqua për devocion e përkushtim në punë, për marrëdhënie të mira me komunitetin e kolegët, për parandalimin e luftën kundër dukurive negative, që dëmtonin rendin shoqëror e civil, kundër korrupsionit, kultivimit e përdorimit të lëndëve narkotike, kundër krimit të organizuar, dhunës, terrorizmit e trafikimit të qenieve njerëzore etj...

Qysh në moshë të re e në vitet e mëvonshme është shquar për frymë humanitare, ndjenjë kolektiviteti e komunikim miqësor me të gjitha shtresat, pa paragjykime krahinore, racore, ideologjike e fetare. Disi në prapavijë e me modesti, është dëgjuar fjala e këshillat e tij miqësore e racionale, si në familje e në fshat, ashtu kur punoi me klasën punëtore apo në organet e policisë.

Në viti 1999 largohet në Itali e punojnë po familjarisht, në Breshia e për rrjedhojë, me kursimet e mbledhura ndërtojnë një shtëpi në Shkodër, e kthyer në një bërthamë gjeneruese prej së cilës zanë fill shumë veprimtari dobiprurëse në shërbim të komunitetit.

Ndarjen nga jeta e të vëllait e përjetoi me shumë dhimbje, por lehtësohej disi e ia mbushte atë boshllëk të krijuar, familja e Pjetrit e në veçanti Sokoli, i cili, siç thamë edhe më lart, me shumë qytetari e zemër plotë e falënderon për kontributin e dhënë të deriatëhershëm

e i lutet të angazhohet rregullisht në Misionin e Madh Mbarëkombëtar...

Duke qenë prej kohësh "Misionar mbarëkombëtar i Pajtimit të gjaqeve e zgjidhjes së konflikteve", puna e tij është e përkushtuar, e gjithanshme e rezultative në bashkëpunim me anëtarë e kontributorë të tjerë të kësaj fushe. Pa dyshim se arritjet janë të dukshme e të matshme, por ka me dhjetëra raste që ato pa drejtësisht nuk publikohen...Po sjellë vetëm një rast sa për konkretizim: deri në janar 2025, 10 familje të ngujuara në Dragoç të Postrripës; pas një pune të gjatë e të kujdesshme, u arrit që të lejoheshin të lëviznin lirshëm e të bënin një jetë e aktive. Këta shembuj e të tjerë, janë konkret e dëshmojnë për një frymë të lartë atdhedashurie e humanizmi...

Themelimi i Fondacionit të Emigrantëve Shqiptarë"- moment me rëndësi.

Kjo ngjarje e realizuar në vitin e kaluar, është shpresë dhënëse në misionin që ka marrë përsipër...

Nga e majta në të djathtë: Kola, Gjeloshi, Maria, Dukatja, Deda eBiba; ulur Pjetra [Pushoftë në paqe!]

FONDACIONII EMIGRANTVE SHQIPTAR "NIKAJ-MERTUR"

I miratuar me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në emër të Republikës, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendimin Nr. 1009, date 16.10.2024

VENDOSI:

"Që Fondacioni i Emigrantëve Shqiptarë "Nikaj-Mërtur", si themelues i këtij Fondacioni të drejtohet nga zoti Bibë Vatnikaj, drejtor ekzekutiv, me të drejta të plota juridike, të mbështetura në statute ligjore dhe si aktivitet i pavarur nga Organet Shtetërore."

Të zhvillojë veprimtarinë e këtij aktiviteti jo fitimprurës, duke ndihmuar Emigrantët Shqiptarë në të gjithë botën ku ka shqiptarë dhe familjet e tyre, por dhe familje të tjera shqiptare në nevojë me kushte të rënda ekonomike...

...Unë vizitova edhe Zyrën e Fondacionit, (e shtëpinë e Bacit); në veçanti pashë dhomën model të punës, me kushte të përshtatshme e mundësi për të projektuar e ndërtuar programe pune, që do të shërbejnë si platforma e orientues për të ardhmen, për t'i bërë realitet, për të cilat ka aq nevojë shoqëria.

Në atë dhomë pune, përveç një dokumentacioni të pasur, pashë të afishuara me kujdes e finesë jo vetëm shumë materiale grafike, në funksion të atij Misioni të Madh, ku është përfshirë Baci, por edhe shumë vlerësime e certifikata mirënjohje nga organe e organizma përkatëse të kësaj fushe, padyshim të mbështetura në punën e palodhur e të gjithanshme që ka bërë e po bën Bibë Vatnikaj.

Shembulli i tij na frymëzon e duhet të na nxitë për sa më shumë unitet e kontribues, për t'i dhënë shoqërisë një ndihmë më të madhe morale, mendore, fizike, monetare a të çdo karakteri pozitiv.

Së fundi edhe një vlerë e shtuar e shumë domethënëse, që duhet përmendur... 5 vëllezërit Vatnikaj, në unitet e harmoni si gishtat dorës, kanë qenë model në shoqëri, duke transmetuar mirësi e qytetari, humanizëm e ura komunikimi, ndershmëri e respekt gjatë gjithë kohës, jo vetëm Pjetri e Biba, por krah tyre (me kontribute të vlerësuara), Gjeloshi, Deda e Kola, pa harruar edhe brezin e ri, që po ecën bindshëm e me suksese në trasenë e shëndoshë që shtroi familja Vatnikaj.

Frrok Vukaj

Oh, Mirditë!...

Gjon Marku

Në zemër të Shqipërisë së Veriut gjendet njëra ndër trevat me të përmendura të truallit shqiptar, Mirdita. Në këto troje të moçme mbruhen dhe ruhen më së miri gjuha, traditat, virtytet e vjen ashtu i paprekur identiteti i pastër shqiptar deri në ditët tona si një testament dhe amanet i brezave që ndër shekuj kaluan rrebeshe e drama të mëdha. E këto cilësi dhe virtyte udhëtuan deri në ditët tona si gurrat e kristalta që burojnë bjeshkëve dhe luginave tona. Hordhi të shumta turke e sllave u sulën këtyre anëve, po këmba s'u zuri dhe në këto toje. Ata s'mundën as ta pushtonin e as ta asimilonin apo tjetërsonin në doke, në tradita, në kulturë dhe etnokulturë që rrezatoji në mbarë trojet Arbënore.

Mirdita është diçka më shumë se një vlerë, më shumë se histori reale, më shumë se një e vërtetë për shumëçka, është një mburrje, një krenari jo vetëm për atë pjesë të kombit tonë në atë pjesë të truallit të lashtë ilirik. Mirdita është një pasuri e veçantë e historisë kombëtare. Në Mirditë ose rreth saj aty afër, pa tjetër me një lidhje të fortë farefisnore, do të kenë lindur figurat më të shquara të kombit. Po fillojmë me Zotin e shqiptarëve, Gjergj Kastriotin, apo Nënë Terezën, këto dhurata e prodhime hyjnore të racës njerëzore. E në radhë vijnë figura të tjera të një rangu të lartë.

E s'kishte si të ndodhte ndryshe, e s'ka si të jetë ndryshe, përderisa ndër këto male e në këtë truall kishin pasur rrënjët e tyre familjet emërmëdha e princërore asnjëherë të nënshtruara e gjunjëzuara. Arbrit, prej nga i dhanë emër e famë gjithë Shqipërisë, e mbushën me lavdi gadishullin e hershëm Ilirik. Fama e nami i tyre gjendej në të gjithë Evropën. Pasardhësit e Arbërve, Kastriotët, Dukagjinët e Blinishtët me princat e famshëm të tyre që u bënë "Kontë" e "Duke" prej perëndimit, zemërluanët, që ndalën hordhi osmane, e që perandoritë e dinastitë më të përmendura të Evropës i vënë dhe i ngrenë në piedestalin më të nderuar dhe më të vlerësuar, janë prej Mirdite.

Kur mbi popullin tonë ra nata më e errët dhe më e zezë e historisë së tij, pushtimi osman, në Mirditë, mirditasit e Mirdita nuk heshtën. Ata krijuan institucionet e tyre vetëqeverisëse. Gazullorët e priftërinjtë rendnin kancelarive të Evropës, që ajo të mos ishte e shurdhër, memece ndaj dramave të mëdha. Armiqtë lëshoheshin me taborë ta pushtonin, ta tjetërsonin, ta shkombëtarizonin, t'ia ndërronin fenë dhe traditat, por maleve të Mirditës mblidheshin kuvende burrash e hartoheshin plane lufte, e s'po mund ta gjunjëzonin. Kodet e tyre të jetesës e mbijetesës, që s'mund t'i gjeje kund tjetër në gjithë botën, i thërrisnin, për kuvend mirditasit e kuvendet vendosnin për luftë, për komb, për fe, e atdhe. Kishave ndër male, këtyre çerdheve të kulturës dhe të dijes hartoheshin alfabete e hapeshin shkolla që të mos zhbëhej e të mos zhbihej ajo kulturë e lashtë, e papërsëritshme, pastërtisht shqiptare. Fëmijët i pagëzonin shqip "Për emër të atit e të birit e të shpirtit shenjt".

Jo rastësisht, në portën e Kishës së vjetër të Ndërfanës (Gëziq) gjejmë të gdhendur në gur mermeri dhe të dokumentuar për herë të parë në historinë e Shqipërisë fjalën "KOMB".

Bij të saj, që nga Mirdita kishin ndëruar vendbanimet, duke u shpërngulur, në pjesë të ndryshme të tokës shqiptare, sidomos në Shkodër, në kryetempullin e lashtë, apo diku tjetër, e prej andej i bënin thirrje shqiptarizmës se "feja e shqiptarit është shqiptaria" bash atëherë kur po kërkonin t'ia tjetërsonin fenë dhe atdheun. E kjo fe ishte e lashtë e hershme, afro 2000-vjeçare. Ishte evropiane në zëmër të së cilës gjendej vetë Gadishulli Ilirik, porta ku nisnin drama të mëdha, sidomos për Shqiptarët. Shqipëria u bë mbrojtësja më e denjë e kulturës së Evropës, dhe asnjëherë ky komb e ky vend s'ia pati me hile, edhe kur ajo e pa me syrin e njerkës.

Evropa i kishe pagëzuar "Princa" Bibë Dodën e Prengë Bibë Dodën. Stambolli s'kishte nga të shkonte e u kishte dhënë titullin "Pasha" (pra të drejtën për të drejtuar 10 000 forca) sepse Bibë Doda dhe mirditasit kishin qenë përcaktues të fateve të luftës së Krimesë, e Papa do t'i jepte urdhrin e Shën Gregorit.

Sa herë Shqipëria është gjetur në zgrip, apo sa herë janë vënë gurë themeli të pashkulshëm, gurë të rendë e të fortë identiteti, gjithnjë e gjithherë ka qenë aty edhe Mirdita e mirditasit me fjalën e vet të mençur e besën e dhënë. Kështu ndodhi dhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ku hidheshin themele të mëvetësisë. Apo Kongresin e Manastirit paraprijësit më të denjë të Shpalljes së Pavarësisë dhe shkëputjes me dije, kuraja, vetëdije e ndërgjegje kombëtare prej ndikimit osman, me të cilin se lidhte asgjë popullin tonë, edhe pse turkoshakë të sotëm s'heshtin së sulmuari Mirditën, mirditasit, apo mundohen të gjejnë ndonjë lidhje me kulturën e tyre.

Ne kurrë s'kemi nënvleftësuar, mohuar dhe përbaltur kulturën e popujve të tjerë. Përkundrazi i vlerësojmë dhe respektojmë ato. Bota e qytetëruar krenohet me kulturën e hershme e të lashtë Sumero-Babilonase dhe Epin e Gilgameshit, si vepër e parë e letërsisë botërore e realizuar me shkrimin kuineiform. Gjithashtu dhe ne shqiptarët, por që ne s'kemi asnjë lidhje, asnjë përngjasim dhe të përbashkët me to ashtu si nuk kemi dhe s'mund të kemi as me kulturën kinezo-tibetiane apo indiano- kinezo - budiste. Por ama të gjithë jemi pjesë përbërëse e kulturës botërore.

Edhe Mirdita vijonte të ishte këtu, në zemër të Shqipërisë së Veriut, bash si një vigane dhe pse dramat dhe pabesitë të mëdha si munguan asnjëherë, por ato e bënin më të fortë e më të lavdishme. Ajo nuk thyhej, nuk gjunjëzohej, nuk binte veç bëhej shembull frymëzimi dhe mbrojtëse edhe e trevave përreth. Sa herë turreshin drejt Malësisë së Madhe a Kosovës që t'i kafshonin, mirditasit ngjishnin armët bash si të ishin dragonj e në krah të tyre gjendeshin.

Mirdita është këtu edhe sot; me hallet e saj të shumta, me qeveri që e lënë në harresë, e turren ta copëtojnë apo luajnë, me të duke i vënë në krye drejtues pushtetesh që nuk ia njohin as vlerat, as madhështinë e saj ndër shekuj, sojsëzë pushtetarë që turren ta rrjepin e që nuk pyesin asnjëherë, për kulturën dhe traditën e saj. Përkundrazi nëpër institucionet që duhet të ruanin e të ruajnë këtë kulturë e traditat, gjenden pikërisht injorantë e shkatërrues të saj, pa pikën e informacionit për kulturën dhe dijen, mjaft që janë militantë partie.

Edhe pse sot mes halleve të mëdha, pa Mirditën, gjithçka shqiptare, kombëtare, do të ishte e mangët, me më pak vlerë. Mirdita është si një unazë e artë kurorëzimi, që në jetë dhe pas saj, e tillë mbetet dhe kujtohet nga brezat.

Ndërkohë që hidhja këto rreshta për Mirditën, në mend më erdhën ca fjalë të Lasgushit të madh, po dhe nëse s'janë të tijat ç 'rendësi ka; ato janë proverbiale e të qenësishme gjithnjë e gjithherë të mirëthëna, që duket se më së shumti i shkojnë Mirditës, që s'mbahet mend qysh kur (së paku që nga koha e Bibë Dodës dhe Prengë Bibë Dodës), s'mundën të ia gjenin një drejtues për t'u mbajtur mend; por veç bishta të vlerave të saj që ia katapultojnë dhe imponojnë herë pas here.

E thonë Lasgushi pat thënë:

-Pushtetarë (sekretarët) vijnë e venë,

Të tjerë shqiptarë bëjnë atëdhenë.

Zot, ndërgjegjësoi sadopak pushtetarët tanë sa të mos shkatërrojnë (siç në fakt po ndodh) atë që brezat ndërtuan dhe kultivuan.

Oh, Mirditë!

Pellazgët janë «shqiptaret me famë» në lashtësi

Shumë të lashtë janë Shqiptarët sa vetë historia e njerëzimit, sa vetë rrënjët pellazge të lashtësis.

Dr. Kujtim Çako

Nisur nga burimet shkencore evropiane, për më shumë se dy shekuj të fundit ka pasur diskutime shkencore "të zjarrta", që hipotezat dhe mitet për çështjen studimore "Pellazgia, Civilizimi evropian dhe trashëgimia historike Shqiptare" të kenë hyre në rrugën e hulumtimit dhe vërtetimit të tezes "Pellazgjike".

Historianet e huaj dhe disa shqiptare e pohojnë periudhën pellazgjike si një teze, që duhet të njihet ndërkombëtarisht jo si mite, por historikisht.

Pellazgët janë evropianë më të lashtë, të cilët i njohim, për shembull, si etruskë në Itali, të cilët njihen gjithashtu si hititë dhe friganë në Anadollin e lashtë, Mesopotaminë dhe të tjerë .

Për të rizgjuar kujtesën kolektive të Evropës dhe të kontribuohet në civilizimin Evropian dhe pse jo edhe Botëror periudha pellazgjike fillimisht nga Historianet e Antikitetit deri tani është vërtetuar si periudhe para - helene. Është duke shkruar e argumentuar për "Zeusin pellazge" jo vetëm si një mite dhe hipoteze, por si një teze me vërtetësi historike.

Të harrosh ketë periudhe është një dem i madh, që i behet Historisë Shqiptare, Historisë së Ballkanit dhe asaj Evropiane e më gjerë dhe vete çështjes Kombëtare Shqiptare.

I- Koncepti Historik i Pellazgëve

1.1 Si i përshkruajnë burimet e lashta

Grekët antikë (p.sh. Herodoti, Homeri, Esiodi) përdorin "Pellasgi / Pelasgi" për të treguar popuj parahelenikë, shpesh të turbullte në burime, pa gjuhë të qartë të njohur, ose me funksione kulturore parahelene.

Në dorëshkrime dhe mitologji, Pellazgët shpesh lidhen me Dodo-

nën, me kultet e parahelene, me elementë natyrorë (pemë, guraleca, orakuj) dhe atributet e "tokës, gurit, natyrës".

1.2 Shtrirja e Pellazgëve në kohë

Kohëzgjatja është e paspecifikuar: Pellazgët si term shfaqen që në periudhat homerike (~8–7 shek. p.e.s.), por burimet nuk japin datë fillestare të qartë për ardhjen ose krijimin e "popullsisë pelasgje".

Disa autorë modernë (jo shkencëtarë mainstream) propozojnë që Pellazgët ishin të pranishëm që në Neolit, në periudhat para qytetërimeve historike në Ballkan, Egje dhe Anadoll. Por këto pohime shpesh nuk bazohen në dëshmi arkeologjike ose gjuhësore të pranuara ndërkombëtarisht.

Shtrirja e Pellazgëve në hapësirë

Ballkani, Egjeu, pjesë të Athinës, Kreta, Troada, Italia Jugore, Greqia dhe Anadolli janë evidentuar si zona ku pellazgët "shfaqen" sipas burimeve të lashta. Shtrirja gjeografike sipas burimeve antike shkruhet se Pellazgët përmenden shpesh si banorë në ishujt e Egjeut, në krahinat përreth Greqisë, Athinës, ishullit të Lesbit, Dodonës, Eubeas, Epirit, Italisë së Jugut dhe përgjithësisht në Ballkanin jugor (përfshirë territore që tani konsiderohen greke).

Dodona shtrihet në Epir bashkë me Orakujt lokalë, kultet natyrore/perënditë para-helene.

Nuk ka burime të plota, që tregojnë se pellazgët kanë mbuluar të gjithë territorin që supozohet si Shqipëria e sotme.

Disa autorë modernë e pretendojnë këtë, por duhen më tepër prova arkeologjike ose gjuhësore dhe të pranuara gjerësisht.

Disa sqarime dhe argumente, disa çështje që deri diku janë kthyer në "përgjigje pothuaj retorike" si:

1. Çfarë janë pellazgët? .

2. Shtrirja gjeografike sipas burimeve antike

3. Gjuha e pellazgëve si një nga çështjet kryesore

4. A ishte Zeusi një pellazg?

Disa sqarime dhe argumente rreth këtyre çështjeve :

2.1- Çfarë janë pellazgët? .

"Pellazgë" (Pelasgians në anglisht) është term që gjendet në burime antike (kryesisht greke) për popullsi ose popuj që supozohej të ishin banues para ardhjes së grekëve klasike në Greqi, ose në disa raste për banorë që grekët i konsideronin "barbarë " jo-grekë por që kanë pasur ndikim paraprak në disa territore.

Grekët antikë nuk japin një vetëdëshmi të hartuar prej pellazgëve – pra nuk dimë me siguri "kush apo i vetë-quajti" pellazgë, as çfarë gjuhe flisnin me saktësi. Greket interpretojnë pa ndonjë argument dhe se terminologjia është shpesh mitologjike, ose e përzier me legjenda. Në një botim Gjerman, kur flitet për Etruskët përmendet lidhja me Pellazget dhe Herodoti se ata erdhën në Lydia me det dhe emigruan në Itali.

Historianet e lashte i kane lidhur ata me Pellazget e Egjeut .

Tre alfabete përdoreshin nga etrusket e Jugut në shekullin e VIII-të deri në të VII-të para Krishtit. Edhe pse etruskët përdornin shpesh shkrime të njohura nga kulturat e tjera mesdhetare, shkrimi i tyre nuk është deshifruar ende. [1)]

Lind pyetja si komunikonin me Pellazget me këto tre alfabete?

Autore të ndryshëm në Evropën Perëndimore, USA e me gjerë flasin më bindshëm për Pellazget, duke e kthyer në një teze të argumentuar, por akoma jo plotësisht.

2.2- A ishte Zeusi një pellazg?

Tek Eskili (Hiketidi), Zeusi konsiderohet paraardhësi i Pellazgut dhe Danaut, dhe Homeri (Iliada XVI, 234) e përshkruan Zeusin si një "mbret pellazg".

Enea përmend (në Episodin II, 57-249) Sinonin (i cili ishte i lidhur me Odiseun) si pellazg, ndërsa vetë Sinoni e quan veten grek.

III. Pellazgët, është vërtetuar se janë evropianë dhe Zeusin shumë të lashtë si pasardhës të Iliro -Shqiptareve sipas konceptit historik.

3.1 - Është e pranueshme që ekzistojnë elemente para-helene në Ballkan.

Disa prej tyre kanë të bëjnë me kultin, me Orakullin e Dodonës, dhe me popuj që quheshin "Pellazgë" në burime antike.

Por lidhja e drejtpërdrejtë midis Pellazgëve, Ilirëve dhe shqiptarëve në termat që përdor narrativë moderne është jo plotësisht provuar sipas standardeve ndërkombëtare të shkencës historike dhe gjuhësisë.

3.2- Ideja që Zeusi, në formën e kultit në Dodonë, të jetë "Zeusi pellazgo – iliro - shqiptar".

Kjo është kushtuar për interpretim, si mit, dhe për afirmim identitet, por nuk ka prova definitive që mbështesin këtë pohim në një mënyrë që është e pranuar nga komuniteti shkencor ndërkombëtar.

IV. Gjuha e pellazgëve: çështjet kryesore

4.1- A ka prova gjuhësore të gjuhës pellazge?

Problemi kryesor: është "gjuha "me siguri pellazge (përveç referencave të jashtme antike), që mund të identifikohen qartë si të pellazgëve.

Emra vendi dhe fisesh (toponime, etnonime) përdoren si referenca argumentuese, por ato nuk janë mjaftueshëm për të rindërtuar gramatikë ose strukturë të plotë gjuhësore.

4.2 -A ishte gjuha pellazge indo-evropiane, ose e para Indo-Evropiane, ose diçka ndërmjet?

Disa prej teorive në shekullin XIX dhe fillim të shekullit XX e lidhin pellazgjishten me një para-Indo-Evropiane, ose me degë indo-evropiane të hershme, ose me një komunitet gjuhësh para-grek (pre-Greek).

Gramatikanë e gjuhëtarë bashkëkohorë janë skeptikë për idetë që pellazgjishtja ishte gjuhë autonome ose identike me gjuhë të tjera (p.sh. greqishten ose ilirishten) pa prova të forta.

4.3 - Lidhja me ilirishten dhe shqipen

Ilirishtja është gjuha ose gjuhët e popujve ilirë, rreth Ballkanit perëndimor, e përmendur në burimet latine dhe greke. Por shumë pak mbetje gjuhësore; përmendje të pakta; asnjë tekst i gjatë i vërtetë nuk ka rezistuar që mund të lidhet qartë me shqipen.

Shqiptarët dhe albanologët (p. sh. Shqiptarologjia) kanë mbrojtur tezën se shqipja vjen nga ilirishtja; studiues si Gustav Meyer kanë argumentuar kështu.

V. Teza pellazgjike – që pellazgët ishin paraardhës të ilirëve dhe për pasojë të shqiptarëve.

Pellazgët janë sipas mitologjisë (të trashëguar nga populli para-helen pellazg), "Pelasgus" ishte njeriu i parë... pelargu ose njerëzit që jetonin në ujëra, ishin një popull i lashtë indo-aziatik, që sipas disa shkrimeve antike të lëna nga (Homeri, Tukididi e të tjerë) jetonin në pellgun e gjumullunges dhe në bregdetin perëndimor të Azisë së Vogël, në Peloponez, në Greqinë Qendrore, në Thesali dhe në afërsi të këtyre viseve.

Në mesin e mijëvjeçarit të tretë dhe në fillim të mijëvjeçarit të dytë para Krishtit erdhën nga stepat e Lindjes grupe të reja popujsh që merreshin me blegtori. Këtu u përzien me banorët vendas dhe kështu u krijua bashkësia e re kulturore e Gadishullit Ballkanik. Kjo popullsi mendohet të jetë popullsia e lashtë pellazge. Gjuha e tyre quhet pellazgishtja. Sipas shumë studiuesve shqiptarë e të huaj, pellazgët ishin paraardhësit e ilirëve. [2)]

Teza që duhet të shqyrtohet e argumentuar më tej :

Pellazgët janë evropianë autoktonë dhe kanë qenë paraardhës, ndër të tjerët, të ilirëve dhe për rrjedhojë shqiptarëve; Zeusi – perëndia kryesore e Olimpit – ka një origjinë pellazgo – ilire - shqiptare përmes kultit të Dodonës apo traditave të lashta.

"Tek Homeri, pellazgët janë fqinj të Trojanëve ... poeti e quan Zeusin që adhurohej në Dodonë të Epirit, Zeusin pellazgjik, gjë që dëshmon se edhe atje banonin dikur pellazgë, [3)]

…..dhe gjithë Thesalinë ose një pjesë të saj e quan "Argos Pellazgjik". [4)]

Si Përfundim:

Kjo teze është mbështetur nga shumë autorë historiane, por duhet më tepër objektivitet, argument dhe prova.

Edhe fjalët dhe tekstet e pakta ekzistuese pellazge zbulojnë një gjuhë greke, megjithëse grekët e lashtë e përshkruanin gjuhën pellazge si "barbare".

Ketë çështje historike, gjeografike, arkeologjike, folklorike, mitologjike, gjenetike e deri te analizat me ane të AI (KI) duhet dhe mundet ta projektojnë për një studim më të plote si Akademitë dhe Institucionet e Shkencave të trojeve Shqiptare: Shqipëri, Kosovë, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi e të tjera, duke arritur në përfundime shkencore të njohura ndërkombëtarësht si një civilizim evropian i munguar deri më sot.

Hulumtimi, përkthimi nga gjermanishtja dhe përpunimi nga Studiuesi Dr. Kujtim Çako.

Burimi:

1) Drei ertruskische Alphabete 8 bis 7Jahrhundert v, Chr. Obwohl die Ertrusker vielfach Schriftzechen benutzt haben , die aus anderen kulturkreisen des Mittelsmeeres bekannt sind , ist ihre schrieft biesher nicht entziffert worden. 1952, fq. 65

2) Enciklopedia e Britanisë së Madhe "Pellazget janë shqiptaret me fame ….".

3) Kënga II (varg. 233) të Iliadës

4) Kënga II (varg. 681)

REDAKSIA
Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

MUNDËSUAN BOTIMIN VËLLEZËRIT, ZEF, KRISTJAN E KLAUDIO PALI, ME BANIM NE CUNEO, ITALI